

Kumbona e së Diellës



KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Nr.7/8, Korrik - Gusht 2017

NJË MIK I SHQUAR I SHQIPTARËVE QË FINANCOI BOTIMIN E ÇETËS SË PROFETËVE

Shën Gregori (Gega) Barbarigo, kardinal, diplomat dhe dijetar (1625 -1697)



Më 18 qershor Kisha e përkujton Shën Gegën (Gregorin). Ai u lind më 16 shtator 1625 në një familje fisnike të Venedikut. Gregori ishte fëmija më i madh i senatorit Giovanni Francesco Barbarigo dhe Lucrezia Leoni, e cila vdiq më 19 mars 1631 nga murtaja. Kurse babai ia besoi edukimin kushërirës Franchesinës Luppomani. Gjatë pagëzimit e mori emrin Gregorio Giovanni Gasparo. Kurse vëllezërit dhe motrat e tija ishin: Elena, Pietro dhe Antonio. Gregori ishte i afërm me kardinalin Barbarigo Mercantonio (1686) dhe me axhën po ashtu kardinal Giovanni Francesco Barbarigo (1719).

Babai u kujdesuar që të arsimohet Gregori fillimisht në filozofi dhe matematikë, si edhe në gjuhën latine dhe greke, po ashtu i merr bazat e muzikës.

Gjatë vitit 1643 Barbarigo e shoqëroi ambasadorin venecianë Aloise Contarinin në

Münster lidhur me negociatat rreth paqes së Verstfalisë, ku u dha fund luftës 30 vjeçare më 24 tetor 1648. Aty ai njoftohet me argjipeshkvin Fabio Chigi, i cili ishte ambasador i papës në Këln, i cili merrte pjesë në bisedime. Pastaj vazhdoi Gregori rrugën për në Holandë dhe Flandri më në fund në Parisë. Pas 5 viteve në korrik 1648 ai u kthye në Venedik dhe vazhdoi studimet në Padovë.

Gjatë vitit 1650 ai u zgjodh anëtar i Collegio dei Savi dhe filloi karrierën politike, ku nuk ishte i kënaqur. Në dimër të vitit 1653 shkoi në Romë për tu këshilluar me kardinalin Chigi (papa i ardhshëm Aleksandëri i VII), i cili ia sugjeroi karrierën kishtarë, dhe vazhdoi të studiojnë ligjin ku edhe doktoron. Kurse më 25 shtator 1655 doktoroi dhe më 21 dhjetor 1655 u shpallur për meshtar nga patriku i Venedikut Gian Francesco Morosi. Një vit më vonë 1656 ai u emëruar nga papa Aleksandri VII prelat në shërbimin e papës në Romë. Më 21 prill 1656 u emëruar rojtar i vulës dhe Gjykatave të Nënshkrimit Apostolik dhe i Drejtësisë. Më 9 qershor 1665 ai u emëruar kanonik në katedralen e Padovës. Gjatë vitit 1656 me kërkesën e papës Aleksandërit VII ai organizoi ndihmën romakëve të prekur nga murtaja.

Më 29 korrik 1657 papa Aleksandri VII emëroi për ipeshkëv në Bergame, ku e riorganizoi seminarin si edhe 279 famullitë e dioqezës. Tregohet si një ipeshkëv shumë i suksesshëm çka papa e emëroi për kardinal gjatë vitit 1660. Gjatë vitit 1664 u bë ipeshkvi i Padovës i cili e zmadhoi seminarin e Padovës dhe të Bergamios si edhe bibliotekën.

Shën Gregor Barbarigo vdiq në Padovë më 18 qershor 1697. Për të lumtur e shpalli papa Klementi XIII më 6 korrik 1761 dhe për shenjtë papa Gjoni XXIII më 26 maj 1960. Kurse festa e përkujtimit është më 18 qershor. Gregor Barbarigo, si ipeshkëv i Padovës, financoi botimin e Çetës së Profetëve në Seminarin e Padovës në vitin 1685 të shkruar nga Pjeter Bogdani.



Redaksia NGJITJA E ZOJËS NË QIELL	4
Don Nosh Gjolaj TË MPOSHTEN KUNDËRSHTIMET	6
Francesco Occhetta S.I POST-REALIZMI APO E POST-NDËRGJEGJA?	10
Dom Lush Gjergji MOHANDAS KARAMCHAND GANDHI	14
Dom Nike Ukgjini ABBAT PRENG DOÇI	17
Redaksia. NGJIZJA E ARSIMIT NË SHKODËR	20
Pjeter Llogoreci KAÇORRI-PERANDORIT FRANZ JOSEF	22
Ndue Dedaj FAMULLIA E GOMSIQES	25
Redaksia NXITJE E TË RINJVE NGA EVROPA	27
Redaksia VITRINA E LIBRIT	28

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXI, nr. 7/8 (497-498) Korrik - Gusht 2017

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Artur Jaku
Dom Gjovalin Simoni

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA
Fotografe: Luli Ndreu

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

TË NGJITURIT E ZOJËS NË QIELL, TË KRISHTERËT TË JENË SHENJË SHPRESE NË BOTË

Solemniteti i të Ngjiturit të Zojës në Qiell është një nga festat më të dashura për devocionin popullor. Kujtojmë se në këtë festë të të Ngjiturit të Virgjërës Mari në Qiell me shpirt e korp, ashtu siç ka besuar gjithnjë Kisha, që nga zanafilla e saj e ashtu si, më pas, Papa Piu XII e shpalli solemnisht më 1 nëntor 1950. Festa e sotme është ftesë për t'i lartuar sytë drejt amshimit, për shikuar lart e për të kujtuar se jeta e njeriut nuk mbaron këtu poshtë; jeta nuk përfundon me të sotmen; jeta tokësore shkon drejt jetës së pasosur, që përplotëson gjithçka

fjalë shprehet bukur domethënia e solemnitetit të të Ngjiturit të Zojës në Qiell. Festa e sotme, na kujton Kisha, na nxit të ngjitemi bashkë me Marinë në lartësitë e Shpirtit Shenjt, ku thithet ajri i pastër i jetës së mbinatyrshme e kundrohet bukuria më e vërtetë, që është shenjtëria.

Të ngjiturit e Marisë me korp e me shpirt në qiell – na kujton liturgjia e festës – është ngjarje e pashembullt dhe e jashtëzakonshme, që e mbush me shpresë e me lumturi zemrën e çdo njeriu. Kështu Zoja e Bekuar bëhet shenjë shprese e



e përmban kuptimin e gjithçkaje. Jeta është shtegtim. Është e pasosur.

Kështu, me solemnitetin e të Ngjiturit të së Lumes Mari Virgjër në Qiell, duhet të mësojmë për t'u bërë edhe ne shenja shprese e ngushëllimi, përballë shfaqjes së trishtuar të gëzimit të rremë e njëkohësisht të një dhimbjeje plot ankth, që vërshon mbi botën bashkëkohore, e një nxitje për ta kumtuar me jetën tonë, ngjalljen e Krishtit! Me këto

ngushëllimi. Kjo festë na nxit t'i lartojmë sytë drejt qiellit; një qielli që nuk është i bërë nga ide abstrakte, e as një qielli imagjinar, krijuar nga arti, por qiellit të realitetit të vërtetë të Hyjit. Hyji është qielli, Hyji është caku nga vijmë e ku dëshirojmë të shkojmë.

Kur Maria ra në gjumë në këtë botë, për t'u zgjuar në qiell s'bëri tjetër, veçse ndoqi për herë të fundit Birin e vet, Jezusin, në shtegtimin e tij më të gjatë e

përfundimtar. Si Jezu Krishti, e së bashku me Të, u nis nga kjo botë, për t'u kthyer në shtëpinë e Atit Hyjnor. E gjithë kjo nuk është larg nga ne, siç duket në çastin e parë, sepse të gjithë jemi bij të Hyjit, të gjithë jemi vëllezër të Jezusit e të gjithë jemi edhe bij të Marisë, Nënës sonë. E të gjithë priremi drejt lumturisë. E lumturia, që të gjithë e dëshirojmë, është Hyji, kështu të gjithë jemi në shtegtim drejt kësaj lumturie, të cilën e quajmë qiell e që është Hyji. T'i lutem Marisë – na fton sot Kisha - të na ndihmojë që çdo hap i jetës sonë të jetë një hap para në shtegtimin drejt Hyjit, drejt këtij shndërrimi që ka të bëjë me çdo njeri e me mbarë gjithësinë.

Ajo, nga e cila Zoti u mishërua, me shpirtin e shporuar nga shpata mbi Kalvar të Krishtit, qe e para që provoi misterin e këtij shndërrimi, drejt të cilit shkojmë të gjithë, edhe ne shpesh herë të shporuar nga shpatat e vuajtjeve të kësaj bote. Eva e re ndoqi pas Adamin e ri në vuajtje, në mundime e edhe në gëzimin përfundimtar. Krishti është fryti i parë, por korpi i tij i Ngjallur nuk mund të ndahet nga ai i Nënës së Tij tokësore, Marisë, e në Të, gjithë njerëzimi përfshihet në Ngjitjen drejt Hyjit.

Është ky një shndërrim në të cilin përfshihet mbarë gjithësia, sepse do të lindë një qiell i ri e një tokë e re, në të cilën nuk do të ketë më lot, as vaj e as vdekje. Ç'mister i madh dashurie na propozohet përsëri sot në këtë festë për kundrim! Krishti fitoi mbi vdekjen me gjithëpushtetin e dashurisë. Vetëm dashuria është e gjithëpushtetshme e të bën të hysh në mbretërinë e jetës. Maria hyri atje pas të Birit Jezus, e shoqëruar nga lumnia e Saj, pasi qe shporuar nga mundimet, duke lënë pas udhën e hapur për të gjithë ne.

E prandaj sot e quajmë 'Porta e qiellit', 'Mbretëresha e Engjëjve' e 'Streha e mëkatnorëve'. Sigurisht nuk janë gjykimet që na bëjnë t'i kuptojmë këto realitete tejet të larta, por feja e thjeshtë, e kulluar, e thellë dhe heshtja e lutjes, që është shumë më e fuqishme se ne vetë e që na ndihmon të flasim drejtpërdrejtë me Zotin. T'i lutemi Marisë – na fton gjithnjë Kisha - të na japë dhuratën e fesë, të asaj feje që të bën të jetosh që tani në përmasën ndërmjet sosjes së jetës e jetës së pasosur, asaj feje që shndërron edhe ndjenjën e kohës.

Duke parë Zojën e Ngjitur në Qiell, e kuptojmë më mirë se jeta jonë e përditshme, ndonëse plot me prova e vështirësi, rrjedh si lumë drejt oqeanit hyjnor, drejt gëzimit e paqes së përkryer. Kuptojmë se vdekja jonë nuk është fundi, por hyrja në jetën që nuk njeh mort. Perëndimi ynë në horizontin e kësaj bote, është agim në botën e re, në ditën e amshuar.

Pra, Kisha na kujton se nga Parajsa, Zoja e Bekuar vijon t'i ndihmojë bijtë, që ia besoi Jezusi, para se të vdiste në kryq, posaçërisht në çastet e vështira të provës.

Sa dëshmi të kësaj mbrojtjeje amtare vërtetohen duke vizituar Kishat e Shenjtëroret që i kushtohen Asaj kudo në botë e po kështu edhe në viset shqiptare! Zoja e ngjitur në qiell na tregon cakun e fundit të shtegtimin tonë tokësor. Na kujton se gjithë qenia jonë – shpirt e korp – është e paracaktuar për jetën e vërtetë; se kush jeton e vdes duke dashur Zotin e të afërmin, do të shndërrohet sipas shëmbëlltyrës së trupit të lumnuar të Krishtit të ngjallur; se Zoti i përul krenarët e i larton të përvujtit (cfr Lk. 1, 51-52). Këtë Zoja e Bekuar e shpall në amshim me misterin e të Ngjiturit të saj në Qiell.

Qofsh e lavdëruar përgjithmonë e jetës, o Virgjëra Mari. Lute Zotin për ne!. Në këtë festë, pra, t'i lutemi Marisë të na shoqërojë në mundimin e jetës sonë të përditshme e të vdekjes sonë, duke na ndihmuar të drejtohem gjithnjë drejt atdheut të lumnive hyjnore.



Don Nosh GJOLAJ
Podgoricë

TË MPOSHTEN TË GJITHA KUNDËRSHTIMET.

(Pjesa e fundit)

5. Mendjelehtësia apo kryelartësia janë gabimet fëmijërore apo naive?

Mendjelehtësia apo kryelartësia nuk janë asgjë tjetër përveçse pasqyra e individit nëpërmes të cilave shprehet personi ende me mendësinë e fëmijës. Një sjellje e tillë lajmërohet pak a shumë në veshmbathje, në modë, në elegancë. Një pamje e tillë sigurisht është që nga koha e lashtë e paleolitit, siç është mënyra e veshjes për t'u dalluar nga ai tjetri, si për shembull ai ose ajo është veshur me lëkurën e ariut, për t'u dalluar nga të tjerët. Sot mjetet e informimit e shfrytëzojnë prirjen e njeriut të sotëm për propagandën konsumuese deri në skaj. Sepse, ai jo vetëm se dëshiron për t'i pëlqyer tjetrit, për t'u treguar, por edhe për t'u dalluar, se unë jam dikush, që eci me hapat e modës, e ashtu jam në vëmendjen e mjedisit. Kuptohet se sjelljet e tilla u sjellin bizneseve fitimet e mëdha, posaçërisht firmave të llojllojshme, të cilat shfrytëzojnë jo vetëm shtypin e ditës, revistat, radion, televizorin, por edhe çdo mjet tjetër, qoftë i informimit, qoftë i reklamës.

Njeriu i sotëm me bindjet e këtilla e ka ndërruar nocionin: nga "të jesh dikush" ai është bërë "për t'i pëlqyer dikujt". Në këtë ka të bëjë edhe diçka me narcizmin, që i jep njeriut vlerën, e lartëson nga pa vlerësimi i tij.

Prej nga buron ky mentalitet fëmijëror?


Në rendin e parë është jo stabiliteti, që e shoqëron njeriun gjatë tërë jetës dhe si e tillë bëhet viktimë e mendjelehtësisë. Madje e kaplon ankthi, apo frika që të tjerët nuk do të na pranojnë, ose do të jemi shumë pak të çmueshëm. Mendjelehtësia buron nga kompleksi apo frustrimi i brendshëm, duke menduar se në syrin e tjetrit jemi më të pavlefshëm nga çfarë jemi në të vërtetë. Frika që nuk jemi të aftë

për t'u treguar pasurinë e brendshme e imponon njeriun për ta treguar shkëlqimin e jashtëm.

I njohim disa tipa të mendjelehtësisë, që nga natyra janë të pafajshëm, siç fjala bie, disa dëshirojnë të fotografohen edhe të jenë në çdo fotografi të pranishëm, ndonjëherë edhe ata që janë në qendër të grupit ose afër atij, që diçka vlen për t'u lëvduar më vonë, se me çfarë personash ai është takuar, ato të cilët ishin në atë kohë të lavdishëm, e të njohur siç janë personat politik, ose yjet e filmit, apo të sportit etj. Nëse dikush lëvdohet dhe krenohet në mënyrë të vazhdueshme, pikërisht aty qëndron kompleksi apo frustrimi i brendshëm, ose zbrazëti.

Kemi edhe të tjera mënyra sesi shprehet mendjelehtësia, për shembull: në punë, në martesë, në situatë ose për heroizëm. Është atëherë kur dëshirojmë përpara të tjerëve të tregohemi si tip guximtar duke i nxitur edhe të tjerët në këtë hap.

Mendjelehtësia, edhe pse është lëshim i vogël, mund të të shpie deri te humbjet e mëdha, ajo bëhet porsì sirena që magjepsë e njëherazi të asgjëson. Sa ka fitoren e dashurisë e cila i dukej më e rëndësishmja, pasi ishte fryt i mendjelehtësisë. Fatkeqësisht, e zbulojmë atëherë kur është tepër vonë. As meshtari që e thotë meshën nuk është i kursyer prej mendjelehtësisë. Janë momentet që pamja subjektive, nëpërmjet rolit që e kryen krejtësisht, shkrihen dhe bëhen një, duke e ngritur



në lartësitrat e larta të krenarisë përpara të tjerëve. E kam stilin e jetës, e kam veshmbathjen, e kam trupin, i kam njerëzit dhe e kryej detyrën, e luaj rolin ku tregoj se para të tjerëve jam krenar. Mund të jem ipeshkëv ose klerik, kolonel apo rreshter, sekretar i shtetit apo zyrtar i thjeshtë, në fund edhe unë jam pjesë e teatrit të madh, që i themi "jeta e përditshme". Kjo dëshirë sipas qejfit mund të më asgjësojë. Krenaria e tillë thuhet se përngjet drogës, jo vetëm se sprovon individin në çfarëdo mënyre për t'i pëlqyer, por ia rrëmben aftësitë edhe për t'iu kundërvënë këtij tundimit, i cili na sjellë një farë kënaqësie, por në anën tjetër ta rrëmben lirinë, dhe si i tillë individ nuk është i aftë për t'i zgjedhur problemet e jetës. Asnjë lëshim tjetër apo gabim nuk e ka aq shumë dimensionin social, siç e ka mendjelehtësia apo krenaria, sepse gabimi i tillë nuk mund të mbesin në vetmi, pasi të tjerët e pohojnë dhe ndikojnë në zhvillimin e saj. Peshkatarët që kishin sukses të mirë në peshkim, gjahtarët që marrin trofetë, adhuresit që pasionohen në partneren e vet të zgjedhur, nuk kënaqen aq për suksesin e vet, por është më tepër në prapavijën e kënaqësisë që pëson, që do të bisedojnë për ngjarjet e tilla edhe më tutje ndoshta për të jetën e tyre.

Sipas La Rockefaucauldës: "*Virtyti nuk do të ecë aq gjatë rrugës, po qe se nuk e shoqëron mendjelehtësia apo krenaria*". Që nuk është asgjë tjetër përveç narcizmit, i cili i këndon lëvdata vetes, e mëkateve të moralistëve, po ashtu është rasti i volitshëm për angazhimin e mëtejshëm dhe gjestet e tilla kuptohen edhe e motivojnë personin në fjalë. Për këtë, mendjelehtësia apo krenaria që është e drejtuar nga e mira mund të kthehet edhe në virtyt, siç thotë C. Castellata, tek "*Leksikoni i ndjenjave*".

6. "Pikërisht je si nëna apo si babai në vend"!

Çifti i ri, prej kohësh ballafaqohet me prindërit, qofshin të burrit, qofshin të gruas, sepse janë personat me të cilët janë rritë, frymëzuar, formuar si individ, kështu ata e kanë pasur ndikimin e madh në fëmijën e vet.

Nuk është lehtë të rregullohen raportet mes nënës e babait, të cilët do të jenë të barabartë dhe të nevojshëm për dy palët, për këtë kërkohet jo vetëm mençuri, por edhe bisedë e përbashkët - kërkohet dialogu, qoftë në rrafshin e të drejtave, në mënyrë që fëmija t'i rregullojë atyre mënyrën e jetesës, që do të jenë për ata të pranueshëm dhe njëherazi prindërit nuk i përjashtojnë.

Në mes të partnerëve menjëherë lajmërohet raporti i quajtur klishe apo stereotip, të cilin e bartin që nga gjiri familjar. Në mënyrë të pavetëdijshme ndikon në fëmijë sjellja e prindit, qoftë ajo e mimikës, qoftë ajo e shprehjeve, qoftë ajo e vetive, si e të mirave ashtu edhe të këqijave, këto vulosen në shpirtin e fëmijës, që aktualizohen apo realizohen posaçërisht gjatë bashkësisë martesore. Zakonisht të fejuarit apo të dashëruarit përpara martesës, apo gjatë fejesës nuk kanë kohë të mjaftueshme për t'u njohur me të gjitha mungesat e dobësitë e të kaluarës, si për njërin ashtu për tjetrën palë, posaçërisht stereotipat apo klishetë që i bartin nga gjiri familjar.

Zakonisht prindi i afron fëmijës përvojat e martesës, por në rastet e shumta, ai është modeli negativ; në anën tjetër fëmija vetëm e imiton prindin edhe sa i përket stilit martesor. Siç fjala vjen, stili predikues, që nuk është asgjë tjetër përveçse fjalë të shumta për ta bindur atë tjetrin. Ndër të tjera edhe imponimi është një prej vetive apo shprehjeve, që nuk është asgjë tjetër përveç fryti i edukimit, po ashtu edhe sulmi ndaj partnerit, po qe se nuk bien dakord mes tyre për ndonjë veprim apo mendim.

Hollësisht mund ta përshkruajmë situatën apo t'i paraqesim të gjitha dëshirat që dëshirojmë për t'i realizuar në gjirin e martesës, por shtegdalja nga kjo rrugë e verbër është se cilat themele dhe cilat mjete do t'i përdorin çiftet për ta realizuar rrugën e përbashkët, në gjirin e martesës.

Zakonisht gjatë një rruge të përbashkët në gjirin e martesës raportet mes tyre dita-ditës janë më të qarta e më të kuptueshme. Një ndër mundësitë është që të ballafaqohen me stilet e llojllojshme të jetës, dhe si kusht i parë, është zhveshja nga paragjykimet, nga shpjegimet e shëmtuara apo gjysmake, nga fjalët e shumta për ta bindur atë tjetrin, atëherë mund të rrimë së bashku pranë tryezës dhe të vendosim për planin e përbashkët, apo për ndonjë problem të pazgjedhur. Po ashtu, mund të ndodhin që çifti martesor i shtron në tryezë të gjitha mundësitë apo nuancat e ndonjë problemi të pazgjidhur apo ndonjë propozimi, por mundohet t'i paraqesin sa më qartë, saqë mos ta përjashtojnë njëra-tjetrën. Por, gjithëherë e kurdoherë është e rëndësishme gatishmëria në mesin e partnerëve për t'u korrigjuar, që nuk është asgjë tjetër përveç detyrës së shenjtë të gatishmërisë së përhershme për korrigjimin e vetvetes, mendimit, duke ndryshuar edhe këndvështrimin apo pikëpamjet që i kemi ndaj problemit apo propozimit, sepse kjo është ajo rruga e cila na mundëson zgjedhjen

adekuate, pasi partnerët mësojnë njëri prej tjetrit, duke qenë se ata gjenden në situatën, e re e jo në gjirin e dikurshëm familjar. Kjo rrugë u mundëson jo vetëm për t'u shkundë nga klisjet apo stereotipat e trashëguara, por edhe për zgjedhjen e suksesshme të çfarëdo problemi apo stili jetese që dëshirojnë për ta realizuar së bashku.

Individi, i cili dëshiron ta krijojë mënyrën dhe stilin e jetës, duhet ta ketë edhe identitetin e formuar përpara martesës, sepse njeriu si i tillë përpos identitetit bartë me veten edhe shumë shprehje apo veti, të cilat ndërlidhen ngushtë me mjedisin në të cilin ai ka jetuar, me mendësinë e rrethit dhe e ndjekin porsia hja të cilën nuk mund ta kapërcëjë, sepse ato nuk janë asgjë tjetër përveç klisheve psikologjike, të cilat janë vulosur në formimin e tij personal, që nga lindja deri në formimin e identitetit të tij. Personi si i tillë, i mbartë me vete, edhe pse nuk është fare i vetëdijshëm për këto modele. Fjala është për bagazhin që e ka pranuar nga kultura e mjedisit, nga civilizimi, nga tradita, nga pozita sociale, nga religjioni apo pikëpamjet etiko-morale, edhe sa e sa të tjera, të cilat i ka pranuar qoftë vullnetarisht, qoftë në mënyrë tërthoras, etj. E kaluara e shoqëron individin siç, e shoqëron edhe hja, e cila vigjilon në vendimet apo përcaktimet e tij, por zakonisht nuk lejon që të depërtojnë rrezet e diellit. Në rastet e shumta çifti martesor shikon e vlerëson nëpërmes këtij kënd shikimi, ata çfarë kanë vërejtur e kanë përjetuar në gjirin familjar kur ende ishin fëmijë, pikërisht nga prindërit e tyre. Në mënyrë të vetëdijshme, por ndoshta nganjëherë edhe të pavetëdijshme qëndrojnë në pozitat e imitimit, që nuk është asgjë tjetër përveçse imitimi i prindit në mënyrë të verbër. Shpeshherë ndodh se sjelljet, përgjigja, mimika janë vetëm imitimi i plotë i prindit. Jeta e përbashkët në këtë rast është ajo rrua e verbër. Partnerët që nuk mundohen për ta ndërtuar jetën e vet specifike në themele të tjera, ose së paku korrigjimin e disa sjelljeve, ata shkojnë nga humnera e pa kthim. Kuptohet vetvetiu se më lehtë është ta

pranosh ata që je i mësuar, që është mishëruar si shprehje, sesa të krijosh mendësinë e re, shprehitë e reja. Nganjëherë mashtrohet çifti i ri, se sjelljet e tilla nuk na sjellin probleme, por mbetet në nivelin e fëmijës, apo në atë situatë që nuk kërkon orvatje të brendshme, as nuk tenton për t'i korrigjuar stereotipin apo klisjet e marra nga trashëgimia. Kuptohet se çifti që nuk vetëdijsohet për t'u korrigjuar dhe për të krijuar jetën dhe stilin e tij specifik, hakmerret herët apo vonë, gjë që nuk i sjell asgjë të mirë, përveçse vdekjes së dashurisë.

Me të tjera fjalë mund të themi me gojë plot, se në çiftin e tillë ende jetojnë prindërit e tyre ose është dora e zgjatur e prindërve, e ndërkohë që prindërit e vazhdojnë jetën nëpërmes fëmijëve. Bile edhe më tepër, disa veti apo shprehje që i kemi marrë nga prindërit, si për shembull stilin e jetës apo ndonjë shprehje tjetër, ia imponojnë edhe çiftit martesor, e në rastet e shumta ato sjellin jo vetëm moskuptim, por dhe frenime psikike apo psikologjike.

Përderisa vulën dhe stereotipat që i trashëgojmë nga gjiri familjar mund t'i shfrytëzojmë në mënyrë tjetër, si fjala bie, përvojat e prindit për t'i zgjedhur problemet konkrete në mesin e ri familjar, jo kopjimin e tyre, por të përdorim mënyrën e duhur sesi të tejkalohen apo të ballafaqohen me problemin konkret. Siç thotë proverbialisht: "*Historia është mësuesja e jetës*"! Biseda apo dialogu së bashku me partnerin, jo



vetëm se do ta qartësojë mospajtimin në të cilën edhe vjen herë pas here nga konflikti, por iu mundëson për t'u ballafaquar e për të zbuluar shkaqet e vërteta. Ata atëherë nuk janë në rrugën, e cila iu mundëson për t'u çelur apo hapur edhe bashkësisë së gjerë, në të cilën edhe personaliteti i tyre jetësohet edhe më tepër.

7. Dy hapa deri te lumturia.

Mund të themi, kënaqësia të cilën e përjeton vetë individi është në veten e personit, i cili di ta përjetojë dhe kënaqësinë vetjake dhe të tjetrit. Po qe se vendosim për çfarë veprimi, gjë që e bëjmë me zemër, kuptohet aty nuk mungon edhe kënaqësia e brendshme. Po ashtu është e vërtetë se fatlumtaria nuk na tërheq, po qe se nuk është së pakut e realizueshme, e vetëdijshme dhe e lirë. Përpara se të vazhdojmë një shpjegim të shkurtër për çështjen, të cilën të gjithë e kuptojmë, në të cilën është fatlumtaria më e madhe, që mund ta përjetojmë në këtë tokë. Me siguri është sipas hulumtimit të bëra deri më tani me përvojat e të dashuruarve dhe përvojat e dashurisë së parë. Në brendinë tonë shpërthen papritmas një gufim i këndshëm i kënaqësisë, të cilën nuk mund ta krahasosh me përvojat e të kaluarës dhe as atëherë kur kënaqësia arrin kulmin e saj dhe ndalet. Siç shprehet Goethe: "*Ndalu për një moment sepse je i bukur*"! Është momenti në të cilin zhduken të gjitha brengat, vështirësitë dhe mungesat njerëzore. Deri në këtë përjetim arrihet vetëm atëherë po qe se edhe tjetri person është i dashuruar, jo vetëm njëra palë, por të dy palët. Po qe se ata sillen në mënyrë perverse vetëm për ta shfrytëzuar njëri-tjetrin, për ta shfryrë impulsin seksual, atëherë ata i ngushton frika ose mëshira. Fatlumtaria e jonë është e varur prej thjeshtësisë e natyrshmërisë që rrjedhë vetvetiu në mënyrë spontane. Po ashtu nuk është e mjaftueshme, ai që është i dashuruar duhet të jetë i thjeshtë dhe për këtë thjeshtësi e spontanitet të natyrshëm ai duhet ta rikthejë dashurinë e marrë nga ai tjetri.

Ky shembull ndriçon shumë gjëra, se fatlumtaria e jonë e plotë, nuk është e varur vetëm prej neve. Dashuria ime është hapja dhe ftesa e personit që e dua. Po qe se ky person nuk përgjigjet jam i humbur. Për këtë është e rëndësishme hapja dhe ftesa dhe njëherë edhe nevoja për përgjigje. Të gjitha këto mund të ndodhin në të njëjtën kohë, në mënyrë spontane e të natyrshme, ashtu siç dëshirojmë. Që do të thotë se dashuria ime pret dhe rrezikon, por është dhe ajo prej së cilës pres edhe

përgjigjem. Fatlumtaria është po ashtu e lidhur me shumë paqartësi, të panjohura, shumë pyetje për të cilat ndoshta do t'i marrim përgjigjet, sepse ai tjetri është krejtësisht i lirë dhe i thjeshtë, me një fjalë i paparaparë. Sa larg është kjo bindje nga ëndrrat! Në jetën e përditshme është fati gjithëherë i papritur, sepse nuk ka ndonjë themel të fortë, lehtë na rrëshqet nga dora, sepse di të jetë i lirë dhe jo kërkues. Vërtetë i përngjanë njeriut, i cili kërkon kënaqësi, por këtë nuk mund ta përjetojnë përpara, sepse ajo vjen si dhuratë, si mrekulli që e lumturon.

Për këtë, duhet që njeriu pa marrë parasysh pozitën, profesionin, vendin ta kërkojnë kënaqësinë për të cilën kërkon shumë guxim dhe orvatje. Sepse situata në të cilën gjendet njeriu, mund të rikthehet në kënaqësi, edhe pse në fillim na duket e pamundshme apo e vështirë. Por gjithçka varet prej vetë njeriut, apo personit. Më së pari duhet të jesh si ora e diellit, që vetë kthjellohet dhe numëron orët e bukura të diellit, përderisa ato të vranëtat nuk i numëron.

Ja një shembull: Një pasanik amerikan, i cili ishte i brengosur dhe i tmerruar, sepse të gjithë pasurinë që e kishte pasur e kishte humbur thajse për një natë, por jo vetëm kaq, ai kishte mbetur edhe borxh. Tani iu sillte nëpër kokën e tij vetëvrasja, i dëshpëruar krejtësisht. Ashtu i tretur, i pa shpresë në jetë, duke bredhur rrugëve të qytetit, në një udhëkryq papritmas ballafaqohet me një njeri tjetër, i cili ishte me dy paterica nën sqetull, sepse nuk e kishte asnjërën këmbë. Papritmas e shikoi invalidin, këtë e vërejti dhe pas disa sekonda ai tha: "*Mirëdita, ditë të bukur kemi sot, a nuk është ashtu zotëri*"? Papritmas shndriti një rreze shprese në zemrën time, dhe them me vete: "*Sa i pasur qenka ky njeri! Unë i ri: po, me dy këmbë e dy duar: po, trupin e shëndoshë, mund të eci, të punoj, çfarë më mungon? U skuqa nga vetvetja. Po qe se ai, pa këmbë është fatlumë, i kënaqur, përderisa unë jam i shëndoshë, pse atëherë ia krijoj vetes ferrin? E ndjeva veten për një moment të lehtë, të freskuar dhe prej brendisë u zhduken të gjitha vështirësitë, brengat e retë e zezat. Vazhdova rrugën jo vetëm i kënaqur, por edhe fatlum*"!

Çdo njeri duhet ta përjetojë udhëkryqin e tillë, kjo vlen për çdo njeri edhe për çdo çift martesor. Çdo njeri, çdo individ e mbartë me vete çelësin, jo vetëm të kënaqësisë, por edhe të fatlumturisë, së dashurisë, pa marrë parasysh sesa i rëndë është kryqi apo barra e jetës!



Francesco Occhetto S.I

KOHA E POST-REALIZMIT APO E POST-NDËRGJEGJES ?

Termi "post-truth", " post - realizmi", sapo ka lindur dhe në "Oxford English Dictionary" është shenjtëruar " Fjala e vitit, 2016 " duke ia saktësuar edhe domethënien: « Faktet objektive ndikojnë më pak në formimin e opinionit publik, thirrjen e emocioneve dhe të besimeve vetjake ». Është koha në të cilën informimi, rrëshqet mes « para » dhe « pas » të vërtetës së fakteve, pa dashur t'i njohë më. Kujdesi që duhet të përdorim për të riformuar faktet, zbatimin e tyre në realitet dhe rigoroziteti i kontrollit të burimeve e rrëzojnë hapin ndaj kulturës post – reale. Kjo zhvillohet falë veprimeve precize si: nxitja e dhunës (hate speech), tallja e mësuesve që mësojnë në institute, prekja e emocioneve dhe e besimeve të personave, të lë të kuptohet që të lind dyshimi në faktet e dhëna dhe falë krijimit të lajmeve jo të vërteta. Terreni i brishtë në të cilën lulëzon post-realizmi është mbi të gjitha rrjeti social, në të cilën formohet konsensi politik, zvogëlohen frikërat dhe konsolidohen identitetet. Ndërkohë që analizojnë vetëm emocionet dhe besimet, ato i qëndrojnë shumë larg fakteve.

Është e folura e përdorur nga populli, në të cilën idealizohet (abstrakti) një lloj " shpirti i pastër " i

matricës hegeliane, siç është, për shembull, ideja e kombësisë, gjaku i pastër, nostalgjia e një të kaluarë epike dhe utopike, iluzioni i një qeverisjeje perfekte dhe superiore ndaj çdolloj realiteti apo fakti konkret. Askujt nuk i intereson që të kontrollojë, andaj post – realizmi dhe post – falsiteti vihen në të njëjtin nivel. Një tregim i detajuar i fakteve është marrë si post – i vërtetë, në kuptimin që është gjithnjë i vërtetë apo i ngjashëm me të vërtetën.

Post realizmi mes praktikës dhe reflektimeve

E përsërisim, në kohën e post – realizmit pak vetëve i intereson të kontrollojë nëse një lajm është i pavërtetë. Madje edhe nëse është i tillë dhe shpërndahet nga shumëkush, ai lajm merret si i vërtetë. Kur lexojmë ndonjë lajm nga interneti, sa nga ne shqetësohen që të kontrollojnë vërtetësinë ?

Një rast konkret, i treguar nga "Il sole 24 ore", tregon funksionimin e kësaj dinamike. Jemi në USA, në Austin, në Texas. Në orën 20 00 , të 9 nëntorit 2016, Eric Tucker publikon në Twitter foton e një autobusi dhe komenton : "Protestat kundër Trump-it nuk janë kaq spontane sa duken. Ja ardhja e pjesëmarrësve". Tucker, i cili dinte për një



protestë në qytet kundër Trump-it dhe është krijuar një lajm i vërtetë, i ngjashëm me të : poston foton e një autobusi që e gjen në Google dhe bën të besojmë që është plot me demonstrues. Lajmi injorohet nga personat që e ndjekin, por ditën tjetër, në 12 :49' imazhi shfaqet në sitin e Trump-it. Në këtë pikë lajmi shpërthen : shpërndahet 16 000 herë në Twitter dhe 35000 herë në Facebook. Kompania e autobusëve është e detyruar që të tregojë të vërtetën. I nxitur nga gazetarët, Tucker përgjigjet : "U emocionova nga imazhi i autobusëve dhe kisha njohuri për protestat". Ndërkohë, Trump shpërthen me këtë postim: "Shumë e gabuar. Profesionistët e protestës janë të nxitur nga media". Tucker e fshin lajmin, por një ortek mesazhesh e zhyt. Në mbrëmje, ripublikon në sitin e tij një postim me shkrimin : "E pavërtetë!", por është shumë vonë, askush nuk e ka vënë në konsideratë.

Lind pyetja: a është e mundur që të vendosim rregulla në post – realizëm ? A do të kushtëzohet ndërtimi i opinionit publik ? Si ? Çfarë përgjegjësie duhet që të ketë gazetaria në raport me ato që komunikojnë përmes lajmeve post – false ?

Për të trajtuar temën, është e dobishme që t'i referohemi tre mendimeve të ndryshme. Para së gjithash, ai i Chiara Giaccardi : "Problemi është që ne nuk jemi vetëm viktimë të pafajshme të post – realizmit (...) kur, për shembull, e varim kompleksitetin e gjërave, arsyetimeve tona, ose transformojmë çështje thelbësore antropologjike në thashetheme apo në shpata vringëlluese kundër dikujt (...) Edhe ndërkohë, e vërteta është e pa ezauruar dhe e pa gjendur. (Pareyson). Pra, nuk mund ta përfitojmë ndryshe, vetëm nga brendësia e një prospektive gjithnjë të pjesshme".

Mendimi i dytë, ai i Giacomo Costa, drejtor i "Agiornamenti Sociali", na fton që të rigjejmë frytet e dialogut të hapur me qëllim që të fitojmë një njeri të vetmuar të rrjetit dhe që të përfshijmë opinionet alternative : "Kush e ka eksperimentuar diferencën mes gëzimit, kush është fryt i takimit të njerëzve në realitet, kush çuditet nga "echo chamber" (një rast i rezonancës), do të gjejë në të një busull për t'u orientuar në këtë kohë. Do të bëhet i zoti për të shoqëruar të tjerët dhe për të gjetur ndjenja dhe rrugë të sigurta për shoqërinë : praktika dhe qendra edukative, informuese, politike, kulturore dhe sociale që do t'i rezistojnë erozionit, edhe në brendësi të tyre do të ndërtojnë mundësi të reja të takimit të njerëzve dhe dialogimit mes tyre, duke respektuar të vërtetën, dinjitetin e gjithsecilit dhe duke shenjtëruar origjinalitetin dhe diferencimin që ai vetë sjell".

Dhe ne mundemi që të qëndrojmë në rrjet duke rikuperuar shpirtin e dialogut : "dialogos" është fjala (logos) që manifestohet mes (dia) dy apo më shumë personave, të cilët krijojnë hapësirën për ta bashkëndarë. Që të mendosh për dialogimin dhe mbi lajmet e vërteta apo të gënjeshtër, nuk lidhet thjeshtë me individualizimin e një strategjie diplomatike, një taktike, një metode, por duhet të zgjedhësh një mënyrë që të na bëjë njerëzorë dhe kërkesë të së vërtetës.

Në fund, mendimi i p. Antonio Spadaro, drejtor i revistës sonë, që i referohet strategjisë në të cilën bazohen disa lajme jo të vërteta : "Gënjeshtër dhe gjysmë e vërteta janë të ndërtuara në art dhe të shpërndara nga një ushtri simpatizuesish". Është teknika "trolling" e organizuar, që e sulmon kundërshtarin deri sa i bllokoi hapësirat e diskutimit dhe sidomos, durimin". Duhet të kesh një armik që ta mposhtësh, por skenari nuk ndryshon nga më përpara, kur "Alternativa ishte mes së vërtetës dhe absurditetit, ose propagandës retorike dhe emocionale. Duhet të dish të thellohesh dhe të dialogosh në mënyrë demokratike me tjetrin".

Është, pra, e domosdoshme që të zgjedhim. Teknologjia nuk është një fund : është një mjet, i përdorur nga njeriu, që sigurisht i ka shumëzuar lajmet dhe i ka vështirësuar kontrollat, ajo: "I gërryen largësitë mendore, i fuqizon rastet e ndërgjegjes dhe rrit sjelljen e informacioneve (të drejta apo të gabuara) në brendësi të rrjetave të marrëdhënieve. Edhe pikërisht sipas këtij kuptimi ajo ka të bëjë me të vërtetën. Në të mirën dhe në të keqen". E vërteta nuk mund të përkufizohet, por ajo ndërtohet së bashku me ato që e kërkojnë.

Post – realiteti, post – autoriteti dhe post-vlera: eklipsi i ndërgjegjes morale

Në të vërtetë, gjuha e post - realizmit është e vjetër. Vetëm ka ndryshuar maskën. E thekson këtë gjë Miguel Benasayag dhe Gérard Schmit, kur nënvizojnë se fillimisht autoriteti është i themeluar mbi ekzistencën dhe rinjohjen e një të mire të bashkëndarë: "Paradoksalisht, kriza e fillimit të autoritetit, nuk korrespondon aspak me dyshimin mbi autoritarizmin. Madje, pikërisht kjo krizë i hap rrugën shumë formave të autoritarizmit. Kjo shoqëri, në fakt, luhatet vazhdimisht mes dy tentativave: ajo e shtrëngimit dhe ajo e pushtimit, të tipit komercial.

Post – realizmi ekziston bashkë me post-autoritetin dhe post-vlerën. E thënë ndryshe, është

si të shpjegosh se në kohën e sotme, në diskutimet publike, seanca e gjykimit a ka të njëjtën vlerë me opinionin e atyre që e komentojnë? Që diagnoza që na jep mjeku vlen sa opinionin i atij që e gjykon? Që vlerat e besimit janë çështje personale, të zbuluara gjatë debatit publik, që vlerësohen sa shijet vetjake?

Në vitet njëzet të shekullit të kaluar, kur udhëzimet u shkatërronin dhe autoriteti nuk ishte i konsideruar si autoritar, rrugëzgjdhja ishte ajo e autoritarizmit. Fatkeqësisht, ajo që harrohet rikthehet. Sot në fakt, ndryshimi i autoritetit ngatërrohet me pushtimin e konsumit.

gjithnjë në veprim dhe nuk mund të ndërpresë "grirjen" e asaj që merr, por është në dorë tonë që të vendosim se cilin material dëshirojmë të ndërtojmë". Francesco fton operatorët e komunikimit që të zgjedhë bluarjen e miellit të mirë, me qëllim që të prodhojë çdo ditë "bukë aromatike". Ka të bëjë me një zgjedhje të lirë, të ndërgjegjshme dhe të përgjegjshme.

Edhe në komunikim shikohet ajo që njihet në brendësi, në thellësi të ndërgjegjes së vet. Papa thekson: "Realiteti, në brendësi, nuk ka një kuptim të njëzëshëm. Gjithçka varet nga mënyra sesi e shohim, nga "syzet" me të cilat ne vendosim ta



Pyetja urgjente për të cilën duhet të reflektojmë është: A jemi në kohën e post – realizmit apo të post-ndërgjegjes, që nuk dimë më të dallojmë të mirën me të keqen, të vërtetën nga e gënjeshtra?

Papa, në realizmin e tij, di që lajmet e vërteta zhvillohen së bashku me ato të pavërtetat. Në mesazhin e tij për Ditën Botërore të Komunikimeve Shoqërore të këtij viti, duke cituar Cassiano il Romano, kujton se: "Paraardhësit tanë antik, e konsideronin mendjen njerëzore si një makinë mulliri, e cila e lëvizur nga uji, nuk mund të ndalohej. Kush është karikuar nga mulliri, ka mundësinë që të vendosë nëse do të blujë grurë apo mosmarrëveshje. Mendja e njeriut është

shohim: duke i ndryshuar lentet, edhe realiteti na shfaqet ndryshe. Nga aty pra mund të fillojmë që ta lexojmë realitetin me "syzet" e duhura?"

Një sfidë : përgjegjësia personale për të komunikuar dhe dhënë lajme

Mundësia për të jetuar në kohën post – realiste si njerëz me vlera morale hapet por edhe mbyllet në brendësinë e gjithsecilit. Siç thoshte Mounier, duke parafrazuar Peguy : " Revolucioni ose do të jetë shpirtëror, ose nuk do të jetë ". kështu hapet dimensionin e brendshëm në raportet e tij me jetën sociale dhe politike.

Një sekret i parë për të vënë në kontrast efektet e

një kulture të post – realizmit është dëshmia dhe mundësia për të dhënë lajme të mira. Këto e mbrojnë jetën, respektojnë dhimbjen, ndërtojnë të mirën e përbashkët.

Sigurisht, etika duhet të respektohet. Kuptimi i saj, fjala rrjedh nga *δεον* dhe *λογος*, "detyrë" dhe "fjalim". Ajo nuk na çon në një koncept statik, por ndryshon me kohën, duke përfshirë përmbajtjen dhe formën e komunikimit që zhvillojnë eksperiencën të reja komunikuese. Duhet të investojmë në kulturë, të përgatitemi me seriozitet për termat e nxehta të politikës që kanë të bëjnë me vetë bashkëjetesën civile, si : antropologjia post-humaniste, raporti mes laikëve dhe islamikëve, mes të drejtës për t'u shprehur dhe të drejtave subjektive, integritimin, ndërtimin e qytetërimit evropian, mbrojtjen e dinjitetit të personave, etj. Lajmet e pavërteta mund të kundërshtohen vetëm përmes memorizimit të fakteve dhe përgatitjes serioze (data, histori, dosje, koherencë për çfarë na thuhet), etj. Veçanërisht delikate , në këtë proces komunikues, janë prezencën dhe vlerësimi i argumenteve. Argumentimi duhet të jetë i prezantuar dhe i vlerësuar, pasi duhet t'i nënshtrohet një gjykimi korrekt dhe kështu, në formulimin e një informacioni të saktë : "Jo rrallë herë në debatet publike të sotme janë prezent në të ashtuquajturin "helmim i pellgut", një procedurë e delegacionit, e cila investon të gjithë atë që një person e afirmon. Është vetëm një metodë, e shumë metodave të gabuara, e strukturuar me argumente korrekte në pamje të parë, që i fsheh artit gabimet e veta logjike, me qëllimin e vetëm: që të gënjejë".

Gazetaria, edhe ajo kishtarë, duhet të ndihmojë që të rregullojmë veten, të korrigjohemi dhe të dimë të kërkojmë falje, duhet të ndalojë format e reklamimit të fshehtë, duhet të na lirojë nga të qenit megafoni servil i të fortit të turnit. Edhe lëshimet favorizojnë kulturën e post-realizmit. Problemi mbetet ai i vërtetimit të burimeve. Vërtetësia e fakteve, pikë së pari është çështje pikëvështrimesh dhe gjuhe. Është "Të dish të shohësh atë çfarë të tjerët shohin, të vësh në rrjet atë për çfarë të tjerët heqin dorë, por që ato ndihmojnë ndërgjegjen dhe transformimin". Është edhe çështje e ndërgjegjësimit kulturor.

Një komunikim transversal i mbi 1200 njerëzish, mes juristëve, menaxherëve, profesorëve, komunikuesve është mbledhur për të parën herë në Trieste, më 17 dhe 18 shkurt të vitit të kaluar, pikërisht për të ftuar që të reflektojmë për stilet e komunikimit. Ka lindur kështu, projekti kolektiv "Fjalë ose Stile" që pretendon të na bëjë të

reflektojmë mbi ndikimin që kanë fjalët në shoqëri dhe mbi rëndësinë e të zgjedhurit me kujdes të fjalëve, në një kohë ku ka shumë fjalë fyese dhe diskriminuese (hate speech), provokime dhe akuzave të pabazuara. Punët janë të ndjekura nga gati 4 milionat e personave që ndodhen në Facebook dhe Twitter. Eventi, i menduar nga Rosy Russo për të diskutuar dhe për të kuptuar fenomenin e dhunës on line, ka prodhuar një manifestim dhe është votuar në rrjet nga 17 000 persona. Ai është imagjinuar si një manual për ta bërë rrjetin një vend më të mirë.

Edhe "Ethical Journalism Network" ka dhënë 2 sugjerime për të bllokuar lajmet e pavërteta që mund të qarkullojnë në linjë. Fillimisht, është e mundur që të verifikojmë lajmet duke përdorur faqet e "fact checking" që na lejojnë një kontroll të dyfishtë të lajmeve. Është e nevojshme të kemi kujdes tek faqet që kanë emra të çuditshëm ose adresave të radha që mbarojnë me "com.co", ato zakonisht janë versione të rreme të siteve reale të lajmeve. Garancitë më të mëdha janë: të kontrollojmë faqen "Kush jemi" dhe t'i kushtojmë rëndësi lajmeve që nuk janë të trajtuara në ndonjë faqe tjetër. Një event që formon lajm duhet të jetë i shpërndarë edhe në faqe të tjera. Kur një lajm nuk ka autor dhe nuk ka asnjë burim nga ku është marrë, duhet të jemi dyshues. Dhe dy pikat e tjera që duhet të nënvizojmë janë: të kontrollojmë datën – një metodë e "lajmeve të rreme" është të marrin lajme të vjetra dhe t'i rilancojnë dhe gjithashtu të jemi të kujdesshëm që të mos ngatërrojmë një lajm të pavërtetë me një lajm satirik, i cili përdor parodi të lajmeve të vërteta.

Pyesim veten: a është akoma e mundur, përballë eklipsit të ndërgjegjes shoqërore, që kontrolluesit e vetëm të jenë gazetarët? Si mund të ndërgjegjësojmë të gjithë njerëzit? Çfarë e krijon dhe e ndërton profesionalizmin tek një gazetar?

Një kujdes të veçantë duhet t'i kushtojmë gazetarisë së shërbimit publik, që është një vazhdim mediatik i ndërgjegjes mes shprehjes së kërkesave të tregut, atij të komunikimit të fakteve dhe, jo të fundit për nga rëndësia, zgjedhjet e vlerave të një qyteti. Nuk ka të bëjë thjeshtë me një delegacion të pavlerë të një elite profesionale, por të kërkitimit të së vërtetës, që shprehet dhe jeton vetëm falë përgjegjësisë së përbashkët të secilit nga ne.

*Material i përkthyer nga revista kulturore – fetare "La civiltà cattolica", 6-20 maj 2017.
Përktheu: Bernardina Shahini*

Dom Lush Gjergji
Prishtinë

MOHANDAS KARAMCHAND GANDHI
(1869 – 1948)

(Pjesa e fundit)

Gandhi mendon në Indinë

Tani mund të kthehet në Indi (1915), si ngadhënjimtar në luftë për të drejtat qytetare të bashkëkombëseve të tij. Pas përvojave në Londër, si dhe punës së bërë në Afrikën e Jugut, duhet të mendonte edhe për Indinë e tij. Ai dëshironte ta lirojë atë nga robëritë e shumta shekullore. Më nuk është i ri, ngase tani ishte 45-vjeçar, kishte përvoja të shumta në luftë paqësore, kishte shumë dashuri për të gjithë njerëzit dhe popujt në vuajtje.


Para çdo veprimi, nevojitet njohuria, të menduarit, urata, agjërimi, përgatitja e mirë për çdo veprim politik. Për këtë, ai krijon një bashkësi të vogël të bashkëmendimtarëve në Sabarmat, qytetin e tij të lindjes, për të pasur mundësi që të këshilloheshin së bashku, për të kërkuar mënyrat e luftimit kundër të këqijave të shumta të Indisë. Po të njëjtin, vit takoi shkrimtarin e madh, fituesin e çmimit Nobel për letërsi, Rabindranatha Tagore-n, i cili e ka çmuar shumë dhe me entuziazëm e quajti „Mahatma", thirrje e cila ka qenë e rezervuar vetëm për Zotin.

Një herë Gandhi tha: " Njerëzit më thërrasin Mahatma, mirëpo unë jam vetëm njeri, e jo Zot. Por si njeri e di që po më ndihmon Zoti për t'iu ndihmuar njerëzve...Populli i Indisë ka nevojë për Zotin,, sepse ka nevojë për Dashuri dhe për të Vërtetën. Jodhuna është forca e vetme e cila gjunjëzon edhe armikun, ia mundëson t'i kuptojë gabimet. Kjo u pa dhe dëshmuar në Afrikën e Jugut, pra, tani duhet të dëshmohej edhe në Indi..."

Jodhuna kërkon përjashtimin e tërësishme të frikës..."

India ishte e copëtuar thuajse tërësisht, tre shekuj nën sundimin anglez, e ndarë në kaste, religjione, plotë mjerim, varfëri, sëmundje të ndryshme... Atëherë kishte diku rreth 5000 principate të vogla. Përveç disa pasanikëve të rrallë, shumica vuante nga uria, padrejtësitë, diskriminimi në çdo hap.

Mohandas Gandhi mendon dhe lutët shumë. Nga kjo analizë e thellë dhe themelore erdhi deri te përfundimi: „Po të kuptonin të gjithë njerëzit, po edhe më tepër, po të kishin vullnet të aplikojnë ligjin e përjetshëm të dashurisë, do të konsideronin mëkat grumbullimin e pasurisë, kështu që atëherë



nuk do kishte më pabarazi aq të mëdha dhe mjerim të papërshkruar, i cili mund të shihet në qytetin e shenjtë Benares, dhe kudo në Indi...Duhet ndërprerë këtë shfrytëzim, jo me largimin e të pasurve, por me vetëdijesimin e të varfërve, duke i mësuar ata që mos të punojnë më për shfrytëzuesit e tyre, mirëpo gjithmonë padhunë, në harmoni të përsosur me satyagrahin."

Ai jo vetëm se fliste, por edhe jetonte ashtu, u vishte krejt thjeshtë, sikur çdo i varfër. Udhëtoi në të gjitha pjesët e Indisë me çdo mjet, me tren, me anije, këmbë...

Jo dhuna dhe mosbindja qytetare

Pas dy viteve të udhëtimit dhe takimeve me popull (1918 – 1920), Gandhi paraqet një strategji të re të mosbindjes qytetare dhe mosbashkëpunimit: "Jo më të punohet për anglezët!" Kështu, për një kohë të shkurtër, gjithçka ishte paralizuar, kurse Gandhi dhe shumë bashkëpunëtorë të tij qenë burgosur. Në gjykatë deklaroi: "Liria është drejtësi, e drejtësia nuk mund të blihet...Unë nuk ndihem fajtor, përkundrazi, kam krye detyrën time..."

Anglia, për ta ndaluar ecjen kah liria, në vitin 1930 ia imponoi Indisë monopolin e kripës. Mirëpo, Gandhi është genial në gjithçka. Zemra e tij e pasur dhe e sinqertë, mendimi i tij i madh dhe i thellë gjente gjithnjë kundërpërgjigje. Ai, shtegtari i lirisë, jodhunës, paqes, drejtohet kah deti dhe këtu bëri një gjest krejt të thjeshtë dhe profetik: "mori një tenxhere e mbushi me ujë të njelmët, më pas nxehu ujin deri në vluarje, dhe kështu fitoi pakëz kripë". Dhe së shpejti në të gjitha pjesët e bregdetit të Indisë filloi prodhimi i tillë i kripës!

Dhe prapë Mohandas K. Gandhi, në mesin e të parëve është në burg, mirëpo bregdetet tani më ishin të "ndezura" nga zjarret e shumta. E akuzonin se ka shkelur ligjin shtetëror të monopolit për kripë. Ai u përgjigj krejt qetë dhe bindshëm: *"Do të lejojmë të na rrahin dhe mbyllni deri sa mos të zgjohet ndjenja njerëzore tek të bardhët...Me kënaqësi pranoj dënimin më të rëndë, të cilin e parasheh ligji juaj. Ajo që sipas ligjit tuaj është krim, për mua është detyra e parë e një qytetari të Indisë... Nëse ka Zot, jam më se i sigurt se Anglia dhe qytetarët e saj do të përgjigjen për këto krime kundër njerëzimit dhe historisë..."*

E dënuan me gjashtë vjet burgim. Anglia ngadalë ndërron qëndrimin ndaj Indisë, dëshiron t'i bënte disa lëshime të vogla, mirëpo Gandhi, as populli, më nuk pranojnë kompromise, por dëshirojnë lirinë e plotë, pavarësinë e plotë. Pas gjashtë muajve burgimi Gandhi lirohet dhe ftohet në bisedime dhe negociata në Londër. Monopoli i kripës ndërpritet, lirohen gati të gjithë të burgosurit politik. Kështu, Gandhi shkon për bisedime dhe negociata në Londër, mirëpo nuk pranon kurrfarë lëshimi në dëm të popullit. Para kthimit në Indi, me shqetësim thotë: *"Kam frikë se edhe pas përpjekjeve të mia, në Indi do të mund të shpërthejë lufta kundër Anglisë. Mirëpo, ne kurrë nuk do të luftojmë kundër njerëzve, por kundër sistemeve të padrejta."*

Përmes agjërimit deri të të drejtat e „parisë"

Për shkak të këtyre deklaratave, pas kthimit nga Londra, prapë qe burgosur. Kësaj radhe e kishte ndërruar strategjinë: Agjëron në rend të parë për bashkimin e popullit të Indisë, e më pas për ta alarmuar opinionin ndërkombëtar. Kështu, arrin deri te përpunimi i konceptit themelor strategjik të tij të dytë: harijan – që do të thotë „Bijtë e Hyjit", përmes kësaj lufte paqësore dëshironte t'i rrëronte të gjitha barrierat mes kasteve indiane, edhe atë përmes dashurisë dhe të vërtetës (ahimsa dhe satya). Përmes agjërimit, lufton për të drejtat e popullit (parisë). Shëndeti i tij keqësohet, nga uria dhe agjërimi jeta e tij gjendej në rrezik. Dëshironte që në përgjithësi ta ndërronte mentalitetin e hinduizmit: *„Nëse e bënë atë, do të vras" në një vizion të ri: „Nëse e bënë atë, unë do të vdes për ju!"*

Bota është e shqetësuar, sepse Gandhi shkaku i agjërimit është rraskapitur gati deri në fund. Nga të gjitha anët e botës merr mbështetje, përkrahje. Mirëpo, ai nuk dorëzohet para „mallkimit të Indisë: kasteve". Thotë: *„Religjioni im më mëson, kur dhimbja është e padurueshme, atëherë duhet të lutemi dhe agjërojmë. Dhimbja ime e madhe është*

për shkak se populli im është i ndarë, më dëgjon mua, por jo edhe ndërgjegjen, të vërtetën, dashurinë."

Për t'iu shmangur vdekjes së tij nga uria dhe agjërimi, pas pak ditësh rrënohen traditat e lashta kastore dhe popullit ju pranuan të drejtat e plota qytetare. Ishte kjo fitore e madhe dhe vërtet e mrekullueshme të cilën e arriti përmes lutjes dhe agjërimit, me ndihmën e Zotit, fitorja e parë të cilën tërësisht e përgatiti Gandhi.

India – shtet i pavarur

Ende ekzistonin dy vështirësi të mëdha: të arrihej pavarësia e plotë e Indisë përmes strategjisë jodhunore, si dhe të pajtoheshin të gjithë qytetarët e Indisë në pikëpamjet religjioze, në veçanti hinduistët dhe myslimanët.

Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, Churchill-I, i cili ishte kundërshtar i ashpër i Indisë dhe Gandhit, humbi në zgjedhje. Partia Laburiste në krye me ministrin Attlee në vitin 1947 e ha lirinë dhe pavarësinë e plotë të Indisë. Një vit më parë Gandhit i vdiq gruaja Kasturbai në burg. Gandhi refuzon çfarëdo funksioni politik. Do të mbetet Babai, Profeti i paqes me mjete jodhunore për Indinë dhe botën mbarë. Deklaron: *"Do t'i shërbej me përvujtëri Nënës së madhe Indisë deri në frymëmarrjen e fundit."*

Edhe ëndrra e madhe e dytë e Gandhit u realizua, India së fundi është shtet i pavarur. Tani është dashur të arrihet edhe te qëllimi i tretë: pajtimi ndërfetar mes hinduizmit dhe islamit.

Gandhi përmes lutjes, agjërimit, strategjisë paqësore dhe jodhunore, satyagrahem-in, ahmisen dhe harians, me 249 ditë burgimi në Afrikën Jugore, me 2089 ditë burgimi në Indi, me dashuri dhe për dashuri arriti në të gjitha, me ndihmën e Zotit dhe këmbëngulësinë e tij shembullore.

Dzhavaharlal Nehru, ishte zgjedhur kryeministri i parë i shtetit në mënyrë demokratike nga 2000 përfaqësues dhe udhëhoqi Indinë e pavarur prej vitit 1947 deri në vitin 1964. Më 14 gusht 1947 në fjalën e tij të rastit, tha:

"Në këtë ditë të lirisë mendimet tona janë të drejtuar kah arkitekti i kësaj lirie, babës së kombit tonë, Mahatma, i cili duke mishëruar shpirtin e lashtë të Indisë, ngrit lartë pishtarin e lirisë duke shndritur errësirën e cila na rrethonte...Fëmijët tanë do duhej të ruanin kujtimin për Gandhin, birin më të madh të Indisë, i madhërishëm në fe dhe fuqi, në guxim dhe përvujtëri!"

Mahatma Gandhi nuk ishte i pranishëm në mbledhjen e parë të Kuvendit të lirë demokratik, por ishte në Kalkutë, në një familje myslimane, duke agjëruar së bashku 24 orë për pavarësinë e Indisë. Ky gjest ishte simbolik dhe profetik. Idealin e tretë ende nuk e kishte arritur, bashkëjetesën vëllazërore mes religjioneve.

Anglia pranoi dy shtete të pavarura, Indinë, shumica hinduistë, dhe Pakistanin shumica myslimanë. Kjo ishte ndarja e parë në baza fetare, të cilën Gandhi nuk e dëshoi dhe nuk e pranoi kurrë. Me krijimin e dy shteteve, ishte krijuar gjendja e tensionuar, e padurueshme fanatike fetare si dhe mërgimi i vazhdueshëm i popullatës, e me këtë edhe rreziku për luftë dhe hakmarrje.

Mahatma ende udhëtonte në pjesë të ndryshme të Indisë, duke folur, mësuar, lutur popullin të jetë tolerantë. Dhe arriti rezultate të mira, sepse njerëzit e dëgjojnë, i besojnë atij. Prapë kishte filluar agjërimin. Me dhembje i thotë kryeministrit Nehru: *"Unë më nuk do kisha pasur fuqi të jetoja po të kisha parë indianët duke u shkatërruar me dhunë mes veti... Ju lutem, pastrojeni zemrat tuaja!..."*


Mahatma Gandhi tani më është mjaft i lodhur, i raskapitur nga agjërimi, nga burgu, nga puna, nga brengat... Edhe njëherë rikujton: *"Bombat askurrë askënd nuk do mund ta shpëtojnë, pra, as hinduizmin... Rrugën të cilën duhet ndjekur është vetëm rruga e paqes dhe jodhunës, rruga e dashurisë dhe faljes... Më humane është të falësh se sa të dënosh. Dhuna është ligj i vërtetë i të egërit, ligj i xhunglës..."*

Nuk dëshiroj të vdes i mposhtur nga pleqëria

Fanatizmi fetar, mes hinduistëve dhe myslimanëve, ishte ende i fortë. Më 29 janar 1948, Gandhi është jashtëzakonisht i lodhur, dhe për këtë flenë më gjatë se zakonisht. Kaloj thujse tërë natën në punë dhe lutje. Para atentatit, sikur të kishte një lloj parandjenje. Për këtë, bashkëpunëtorët më të ngushtë i përkujtoi: *"Nuk dëshiroj të vdes si një njeri i mposhtur nga pleqëria. Më parë kisha pranuar një plumb nga vrastari, i cili ka mundësi qysh nesër të më vras, sepse do të ma jepte rastin që të vdes gjatë kryerjes së detyrës sime."*

Dhe kështu ndodhi më 30 janar 1948 pasdite, në përcjellje të bashkëpunëtorëve të tij, erdhi në kopshtin e vet për lutjen e mbrëmjes. Vrastari Nathuran Vinayak Godse, brahman, ia mori jetën. Gandhi thjesht tha: *"Zot, O Zot"* dhe fill vdiq.

Ishte kjo goditja më e dhembshme dhe më e rënda për popullin e Indisë. Njeriu i cili kishte arritur të shkatërronte ndarjen shumë shekullore në



kaste, i cili kishte krijuar zbatuar strategjinë jodhunore, arriti lirinë dhe pavarësinë e Indisë, ra viktimë e dhunës dhe urrejtjes fetare. Bota është në pikëllim. Nehru duke qarë tha: *"Vdiq babai i Indisë. Drita e jonë është shuar. Babai i Indisë, miku, ngushëlluesi i gjithë neve, nuk është më në mesin tonë."*

Mirëpo, vdekja nuk është fund për njerëz të cilët jetojnë dhe besojnë në Zotin, në njeriun, në të nesërmen më të mirë. Gandhi besoi thellë, dëshoi fuqishëm dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse, punoi për të mirën e të gjithëve. Foli shumë thjeshtë: *"Unë jam pjesa qindëmishe e Indisë dhe botës... Krishti nuk e barti kryqin vetëm qysh para 1900 viteve, por vdes dhe lind për çdo ditë. Jeta dhe vdekja e Tij do ishte e kotë, nëse nga Ai nuk mësuam të rregullojmë jetën tonë sipas ligjit të amshuar të tij, atij të dashurisë. Kudo është dashuria e plotë, pa dëshirë për hakmarrje, aty është i gjallë Krishti... jeta dhe porosia ime. Unë kam besim në njerëz, sepse kam besim në Zotin. Për mua Zoti është Rruga, e Vërteta, Drita. Hyji është Dashuri."*

Ai mbolli në zemrën e botës farën e jodhunës dhe atë e "ujiti" me gjakut e tij martir. Ne na mbetet të mbledhim frytet e kësaj korrijeje të madhe, për të pasur mundësi t'i mbesim besnikë vetvetes, Zotit, njeriut bashkëkohor.

Mahatma Gandhi shpesh thoshte: *"Unë jam një shtegtar i tretur drejt jetës së amshuar."* Ai na dëshmon: *"Unë më nuk jam i aftë të urrej. Përmes lutjes, agjërit, meditimi më tepër se 40 viteve jam munduar t'i dua të gjithë... Vetëm dashuria mund të shpëtojë botën..."*

Pa dyshim se unë do bëhesha i krishterë, po që se të krishterët do ishin të tillë 24 orë në ditë... Krishti është udhëheqësi i jodhunës. Ai nuk u përket vetëm të krishterëve, por gjithë botës... Guximi i jodhunës rrjedh nga besimi se në zemrën e gjithë njerëzve është Zoti..."



Dom Nike Ukgjini
Shkodër

ABBAT PRENG DOÇI, PËR GJALLËRIMIN DHE LULËZIMIN E SHQIPËRISË

Abat Preng Doçi (7 shkurt 1846 – 22 shkurt 1917)

(Pjesa e fundit)

*(Konferencë përkujtimore, "Gjurmime Albanologjike"
organizuar dt. 2. Qershor 2017, nga Universiteti i Shkodrës)*

Kthimi në Atdhe dhe vazhdimi i misionit në shërbim të Zotit e popullit

Pas shumë peripecive diplomatike, Shkodër, Romë, Stamboll e Vjen, më ndihmën e Austro-Hungarisë si garant pran portës së Lart, Doçi me 27 tetor 1888, arriti pas 11 viteve mërgimin të kthehej në Shkodër, duke u caktuar abat në Oroshin e lavdishëm. Kthimi sipas dekreti të sultanit dorëzuar Bahri Pashës në Shkodër, ishte kushtëzua që mos të merrej më politik dhe veprimtaria tij kërkonte që mos të kalonte kufijtë e Provincës së Mirditës.

Doçi, si autoritete i lart kishtare i cili tani varej nga Roma dhe Vjena, i kishte dhënë vetes më tepër detyrë, për të punuar në rrugën e veprimtarisë kishtare, për rimëkëmbjen e kishave të shkatërruara nga turku, për liri dhe të mirën atdheut. Përkundrejt pengesave që kishte përpara, punonte më plote energji për fuqizimin e faktorit të brendshëm me anë të besës e bashkimit, zhvillimit të jetës kulturore e shpirtërore. Mbarimi i shek. XIX, përben një moment me rëndësi në historinë e Mirditës, pasi me nxitjen e Doçit u shënjua lulëzimi me i madh i përpjekjeve të shqiptarëve për liri kundër ushtrisë Turke. Qëllimet e Abat Doçit, ishte edhe përfshirja e shqiptarëve të Mirditës në koalicionet politike të Evropës, çfarë do përfitonte dhe Shqipëria.

Abat Doçi, punoj me përkushtim të pazakontë, në ruajtjen, kultivimin dhe ngritjen e vetëdijes kombëtare duke dhënë dëshmi se është e mishëruar thelle në popull. Kambanat kishe se Oroshin kanë ranë jo vetëm për meshë, por edhe për meshën e lirisë duke i ngritur malësi në kushte të njëpasnjëshëm.

Sundimi turke u përpoq me të gjitha fuqitë e saj ta nënshtonte Mirditën por nuk qe e mundur pasi mirditasit nuk pranuan për asnjë çmim sistemin timarve e ndërrimit të besimit, tjetërsimin e kulturës shekullore të popullit të Arbrit. Kujdesin për kultivimin e kulturës arbërore Primo Doçi (Preng Doçi), e kishte treguar edhe gjatë qëndrimit të tij të përkohshme në Mal të Zi. Ai në relacionin e tij nga Tivari dërguar në vitin 1883 Kongregacionit për Përhapjen e Fesë, në mes tjerash thotë, se përveç në Cetinë e Rijeka (mendon në Rijeka Crnojeviq), ku

jetojnë 92 katolike nga Shkodra, ka të tillë dhe në Nikshiq dhe në Danillovgrad.

Në vargun e organizimeve përgatitore për t'i kundërshtuar Perandorisë osmane në Shqipëri, ishte mbledhja e fshehtë e vitit 1893, organizuar në famullinë e Shkrelit (Malësia e Madhe). Gjykuar nga rëndësia e personave pjesëmarrës dhe ngjarjeve që pasuan, themi se, në këtë takim, qe hedhur një nga platformat e rëndësishme për organizimin e lëvizjeve dhe kryengritjeve popullore kundër sundesve osmanë.

Në mbledhjen e Shkrelit, Nikaj dhe Doçi, ndër të tjera, ishin zotëruar se do merreshin me afrimin e shqiptarëve të dy besimeve, katolikë dhe myslimanë. Në qytetin e Shkodrës, përçarja e shkaktuar nga turqit sipas, Nikajt, ishte e dukshme. Sipas këtij konstatimi, rezultoi se afrimi i shqiptarëve të dy besimeve, do ishte puna bazë për përgatitjen e lëvizjeve dhe kryengritjeve, që do të zhvilloheshin kundër Perandorisë osmane, deri në shpalljen e plotë të pavarësisë së Shqipërisë.

Nikaj, edhe përkundrejt pozicioneve të ndryshme kishtare që kishin me abatin e Mirditës, Preng Doçin, ndërmjet tyre mbanin lidhje të ngushta miqësie. Të dy kishin të njëjtin drejtim politik, "Shqipënin e lirë e vetsunduese" thekson Nikaj.

Abat Preng Doçi, letrar, hulumtues dhe diplomat, kishte paraqitur para krerëve të Mirditës në Orosh, në vitin 1897 programin me të cilin parashikonte organizimin e lëvizjeve dhe kryengritjeve nga 1897-1900 dhe në vazhdim. Në këtë program sipas konsullit, Theodor Ippeni, të datës 25 qershor 1897, ishte paraparë bashkimin e tri krahinave: Malësisë së Madhe, Dukagjinit dhe Mirditës, nën administrimin e Prek Pashës. Duke pasur parasysh se ai, kishte pozicion të lartë kishtar, mori përsipër, para të huajve ta paraqesë programin si një ndërmarrje spontane të disa patriotëve e jo, si të udhëzuar nga ai apo nga Austro-Hungaria. Meqenëse kisha katolike në Shqipëri, që në vitin 1837 ishte nën protektoratin e kultit të Austro-Hungarisë, Doçi, me 7 dhjetor 1897, raporton Vjenën lidhur me programin në fjalë.

Duke qenë se Doçi ishte Abat i një abacie të një

rangu me dioqezën, kthimin në Mirditë, në vitin 1888, e kishte të kushtëzuar nga diplomacia evropiane si garant para Perandorisë osmane, për mosangazhimin e tij në politikë. Prandaj në veprimtarinë tij atdhetare u detyrua të ishte shumë i fshehtë dhe më i rezervuar në raport me çështjen në fjalë. Sidoqoftë, puna e tij nuk pat të ndalur, sepse vazhonte të merrte pjesë tërthorazi apo drejtpërsëdrejti në organizimin e kryengritjeve të popullatës për çlirimin e vendit nga zgjedha turke.

Për punën e tij të pa lodhur dhe heroike, diplomacia austro-hungareze do të shprehej se emzot Doçi, ishte burrë i zgjuar dhe energjik, i cili e kishte marrë përsipër që të realizojë bashkimin politik të fiseve shqiptare.

Filozofi francez, Zhan Pol Sartër ka shkruar se "nuk mund të jesh intelektual po që se nuk zotëron, përveç dijes edhe guximin". Doçi, duke e poseduar edhe njërin dhe tjetrën, vazhdoi të nxiste popullin në organizimin e kryengritjeve. Ai, që frymëzues i organizimit të kuvendit të mbajtur gjatë muajit prill në Kimëzë dhe më vonë në Fan të Mirditës në vitin 1911, në të cilin ishte vendosur të kundërshtoheshin sanksionet e ndërmarra kundër popullit, nga Perandoria osmane.

Nikaj, dhe Doçi u gjetën edhe në vorbullën e shpërthimeve të kryengritjeve në Malësinë e Mbishkodrës, gjatë muajt mars-gusht vitit 1911. Doçi në vazhdim që përkrahës i mbajtjes së Kuvendit në Kullmet të Lezhës, në tetor të vitit 1911, kur krerët e 12 bajraqeve të Mirditës vendosën që të mos u binden autoriteteve osmane. Gjithashtu, Abati përkrahu dhe nxiti mbajtjen e kuvendit të Rubikut, organizuar po në këtë vit, në të cilin u hartua projekt-kushtetuta për Shqipërinë autonome, e cila në raportet e konsujve quhej Memorandumi i mirditasve. Kjo projekt-kushtetutë që prezantuar, nëpërmjet delegacionit mirditor dhe në Besëlidhjen e Shkupit, me 10 gusht 1912.

Nuk ka dyshim se Preng Doçi, klerik i lartë, qëndronte në ballë të lëvizjeve dhe kryengritjeve kombëtare si vizionar, me mjetet që i lejoreshin. Në lidhje me këtë, flet dhe fakti, i letërkëmbimit të vazhdueshëm të Doçit, me deputetin e Perandorisë osmane, e më pas kryetari e qeverisë së përkohshme të Shqipërisë, Ismail Qemalin nga viti 1903, deri në 1912 dhe me pas, duke menduar për rregullimin e gjendjes dhe pas shpalljes se pavarësisë së vendit.



Angazhimi kulturor i Doçit

Romancieri i parë shqiptar Dom Ndoc Nikaj, në "Kujtime të një Jetës së kalueme", rrëfen se hartimi i programit kulturore i Doçit ndodhi në kohën kur Nikaj qëndronte në krye të famullisë së Shkrelit. Takimi, rrëfen, Nikaj, që mbajtur në vitin 1893, dhe pjesëmarrës ishin, abati i Mirditës Preng Doçi; prifti i Velipojës, Dom Mark Shllaku; i Rrjollit, Dom Zef Shkreli; i Shkodrës, dom Jak Sarreqi, dhe prifti nga Mirdita, dom Dodë Koleci. Synimi i tyre, sipas tij, ishte formimi i një lidhje kombëtare e cila mori emrin "Bashkimi Shqiptar". Në vazhdim Nikaj shprehet se: *"Nuk bame shkresa që mos të ndodhte rrezik zbulimi nga ana e qeverisë turke edhe të n'a nxente me prova në dorë"*. *"U lidhme më shkruie në giuhen shqype se i cili mbas andjes së vet dhe mbas prirjet perkatëse"*.

Si rezultat i takimit në Shkrel, ishte formimi i Shoqërisë *Bashkimi* në vitin 1899, e me seli në Shkodër e udhëhequr nga abat Doçi dhe nga ku 1908 doli *Fjalori i Ri*, i gjuhës shqipe i cili vlerësohej lart nga, prof. Ahmet Kelmendi e prof.. Gaetano Petrotta

etj. Duke vlerësuar lart punën e kësaj shoqërie ne lëmin e letërsisë Luigj Gurakuqi shkruante: "Akademia Bashkimi, në pak vjet solli shumë ndihmë literaturës sonë me botime te veta te vlefshme".

Duke pasur parasysh vështirësitë e mëdha të Preng Doçit si klerik i lart në Mirditë, lista e shoqërisë Bashkimi është e gjatë dhe e larmishme. Për afro 9 vjet nga themelimi i saj deri ne Kongresin e Manastirit, (1908) vuri në qarkullim mbi 35 libra nga autoret e fusha të ndryshme. Në kohën e lirisë Konstitucionale (1908), e cila ishte një manovrim perandorak, Nikaj, hapi në Shkodër në vitin 1909 veprimtarinë e tij botuese, duke siguruar një shtypshkronjë të vogël me pakicë germash. Në janar të vitit 1910 ai filloi të botonte së bashku me Doçin, gazetën "Koha", e cila duke filluar nga numri i dytë, doli me emrin "Bashkimi" dhe si motiv të vetin kishte kujdesin për punët kombëtare dhe të diturisë.

Doçi, më të drejtë është cilësuar edhe si mbrojtës i nismave në lëmin e hapjes se shkollave ne gjuhen shqipe. Me kontributin e tij, rihapet shkolla në Orosh ne vitin 1899. Me pas u çel shkolla në Spaç, Kashnjet, Rrëshen e Rubik. Në 5 shkollat fillore në Mirditë në vitin 1904, ndiqnin mësimet në shqip 96 nxënës. Pa u ndalur para vështirësive Doçi dhe shoqëria *Bashkimi*, botuan librat të të gjitha lendeve, për të tera rendet e shkollës fillore.

Doçi dhe shoqëria Bashkimi, e mbronin me fatalizëm në Kongresin e Manastirit alfabetin e Bashkimit, duke u shprehur se: "është me estetik e me latin, ruan etimologjinë e gjuhës, është sistem i përdorur nga të paret tanë, Budi, Bardhi, Bogdani dhe arbëreshët, etj". Duke u shqyrtuar nga ekspertet e gjuhës, alfabeti i Bashkimit mori epërsinë e duhur në formimin e alfabetit te Manastirit.

Studiuesi i abat Doçit, Pal Pjeter Doçi, shprehët se, "pa mohuar punën në lëmi të tjera, Prend Doçi, ka bërë emër në radhë të parë si poet dhe në poezinë shqipe të rilindjes, ai është një nga më të spikaturit." Edhe nga studiues të tjera dëshmohe fakti se pjesa më e madhe e krijimtarisë se tij, ka humbur e një pjesë tjetër është botuar pa emër.

Prof. K. Denio, nga Franca, do shkruan, "Greqinë moderne e bënë detaret dhe tregtarët, Shqipërinë e bënë poetet". Duke u mbështetur në dëshmitë e Dora, d'Istria për abatin, themi së Doçi ishte njëri ndër të tillët.

Përfundimi

Sipas vlerësimeve të Pal Pjeter Doçit, abati i Mirditës, Preng Doçi, i rrahur me jetën kishtar e politike, nuk ka dyshim se i njihte pikësynimet e shteteve të ndryshme evropiane ndaj Shqipërisë dhe qëndrimet e tyre ndaj çështjes kombëtare shqiptare. Në mënyrë të veçantë ai ndiqte më shumë vëmendje qëndrimin e Vjenës ndaj Shqipërisë, sidomos kur

kishte të bënte më të drejtën e protokultit dhe të kulturës shqiptare. Si largpamës dhe i matur Doçi kishte nuhatur dhe zhbirilua rivalitetet politike për Ballkanin në mes Rusisë dhe Austro-Hungarisë. Disa diplomat e kane vend ne dukje se Doçi, synonte të jetë sa më i kontrollueshëm në punën e vet, për ta ruajtur sa me tepër pavarësinë e Mirditës, si nga Austro-Hungaria dhe Italia, duke ngritur tensione të vazhdueshme më pushtuesit osman. Qëndrimi i tij ndaj disa ngjarjeve ne Mirditë e rreth saj ka shkaktuar jo pak dyshime, interpretime të ndryshme, mosbesime, e deri në akuza gjithfarësh. Të gjitha ata qe e kanë njohur, qofshin shkrimtar, udhëtar, diplomat apo historian, thonë se Doçi ishte i mbyllur, kishte një karakter misterioz i pa parashikueshëm i pa depërtueshëm. Duke qenë i mbyllur e i papërmbyllur dhe i matur e i prerë ai kishte autoritet edhe tek ndërkombëtares. Edith Durham do shprehej: Ajo shkuan se Abati i Mirditës, Preng Doçi, ishte një njeri me veti të shquara. " Ai kishte mërguar nga Shqipëria në moshë të re, pas pjesëmarrjes në Lidhjen e Prizrenit pasi kishte nxitur shqiptarët për rezistencë ndaj sundimit turk dhe dekreteve të Traktatit të Berlinit, ai i kaloi vitet e tij të syrgjynosjes në Newfoundland (Kanada) dhe Indi ,duke punuar si prift, ku kishte mësuar anglishten dhe kishte lexuar shumë. Ai ishte shpikësi i një sistemi të shkëlqyer të alfabetit shqip të cilit ia kishte hequr të gjitha theksat, duke përdorur vetëm germa të thjeshta latine. Ai madje, i bindi autoritetet austriake ta përdornin atë alfabet në shkollat e tyre, dhe ishte entuziast për librat që ai kishte për të përgatitur. Planet e tij ishin mjaft të gjera dhe përfshinin përkthimin e shumë librave standarde angleze në gjuhën shqipe. Ai madje kishte hapur një shkollë të vogël në kishën e tij në mes të maleve". Sipas Shahin Kolonjës, abat Doçi vlerësohet si shumë i përmendur, por pak i njohur, sepse ne ende nuk jemi orientuar për kah kulmet e historisë. Prej këndeje duhet nisur analiza e veprës së tij komplekse, si poet i fillimeve të Rilindjes, prelat i lartë kishtar e reformator kishe, flamurbajtës. Më 22 shkurt shënjohet vdekja e Abatit të Oroshit të Mirditës, Imzot Preng Doçit (1846-1917) si bari i vyer, letrar i shquar dhe atdhetar i flakët. Atë Gjergj Fishta me rastin e vdekjes së tij, në gazetën *Posta e Shqyniie*, të vitit 1917, nder të tjera do shprehej: "...emundet me u thanë për siguri se nuk asht kund një skaj Shqypniet, ku burrat e mëçem a'kalemit mos ta kenë ndie e përmend ket emen". " Ka pas ndiesi poetike fort te shqueta, në rini ka pas shkruar vjersha të bukura e me nam".

Vdekja e Doçit pati jehon edhe të Konsulli Austriak, Agust Krajl, shqiptaret: Filip Shiroka, Zef Skiroj, e Ndoc Nikaj e shumë të tjerë.

Marrë nga gazeta: *Shqiptarja.com*,
dt.4. qershor 2017.

NGJIZJA E ARSIMIT NË SHKODËR-SHQIPËRI NË VITIN 1877

140-vjetori i themelimit të Kolegjit Saverian në Shkodër, 1877-2017

Kolegji Saverian i Etërve Jezuitë në Shkodër e filloi veprimtarinë e vet në shekujt e kaluar, duke përballuar vështirësitë e pushtuesit, pengesat e fanatizmit e sulmet e antiklerikalizmit vendas. Kështu mund të themi se interesi i Jezuitëve për kulturën shqiptare është më i hershëm se Kolegji; nis që në shekullin XVIII, kur Papa shqiptar Klementi XI, posa organizoi Kuvendin e Arbënit dhe i kërkoi dokumentet edhe në gjuhën shqipe, hodhi idenë të mbledheshin materiale e dokumente iliro-shqiptare. Mbledhjen e filloi Atë Riçeputi e e vazhduen etërit jezuitë Daniel Farlati e Jakob Koleti, që realizuan veprën historike fort të çmueshme "Illyricum Sacrum", një vepër "*sine qua non*" për historinë e Shqipërisë.

Ardhja e jezuitëve në Shqipëri do të shoqërohej me veprimtari të dendura fetare, arsimore, kulturore e shoqërore, të panjohura më parë në vendin tonë. Ndër këto veprimtari kujtojmë ngritjen e shtypshkronjës së parë, botimin e revistës së parë "Elçija e Zemrës së Krishtit", krijimin e bandës së parë muzikore e të orkestrave moderne, fillimin e artit dramatik, lulëzimin e shoqërive kulturore, patriotike e sportive, mbledhjen e koleksionit të famshëm numizmatik, hapjen e Muzeut botanik, etnografik etj. etj.

Jezuitët nisën edhe punën arsimore. E filluan me një shkollë të vogël, me pak nxënës, për të arrit te viti i paharrueshëm 1877, data 17 tetor kur në praninë e arqipeshkvit të plak i Shkodrës, Carlo Pooten e të At Zef Lombardinit hapi dyert një institucion i ri me emrin e Shën Françesk Saverit, që populli shqiptar do ta kujtojë gjithmonë me nderim e mirënjohje si Kolegji Saverian. Ndër themelues kujtojmë At Luigjin Maca, që dhuroi nga pasuria e shtëpisë së vet 1100 napolona. Ndër laikë civilë duhen përmendur familjet shkodrane: Muzhani, Sima, Suma, Saraçi e Shiroka.

Stema e Kolegjit: në ballë shqipja dykrenore, sipër: 'Për Zot, Për Atme e Përparim'. Filluan mësimet me seriozitetin e jezuitëve: arsim i vërtetë, i plotë, i rregullt; kulturë e përgjithshme perëndimore, qytetërim i zgjedhur evropian, me programe të studiuara e të zgjedhura; me metoda

të përparuara e efikase; me mjete moderne e të reja. Shkurt, një formim i gjithanshëm perëndimor.

Me të drejtë Papa Piu X i pati thënë Imzot Serreqit: "Jeni të lum që keni jezuitët në Shkodër". Shkolla në fillim pati drejtim tregtar, më vonë mori drejtim klasik, por gjithmonë qe e barasvlershme me shkollat më të mira të mesme të Evropës Perëndimore. E kjo edhe pse mësuesit që dhanë mësim në këtë shkollë qenë të gjithë me shkollë të lartë të kryer jashtë shteti, të gjithë autorë tekstesh a veprash me karakter letrar, gjuhësor, historik, filozofik etj.; të gjithë me një botë të pasur shpirtërore e intelektuale, të gatshëm për të zhvilluar fuqitë mendore të nxënësve për një formim intelektual të shëndoshë, por edhe për emancipimin e jetës shoqërore e kulturore si dhe për integrimin e shoqërisë shqiptare në Kontinentin e Vjetër, në mënyrë që Shqipëria, gjeografikisht në Evropë, të mos mbetej realisht në Orient. Rrallë ka shkolla me kuadër të tillë arsimor: Atë Jak Jungu, misionar italian me zemër shqiptari, si i thoshte Shantoja, autor i një gramatike dhe i një Fjalori dygjuhësh; Atë Anton Xanoni, italian me nënë shqiptare, që shkroi vetëm shqip për ne, autor i "Prijsi në lamë të literaturës", dhe "Gramatika e gjuhës shqipe"; Atë Fulvio Kordinjani, autor i shumë veprave; Atë Buxeti i 'Fjalorit' të madh; martiri Imzot Bonati që përktheu 'Lahuten e Malcis' italisht. Pastaj Atë Aldeghieri, Atë Fracchioni, Atë Zef Valentini, autor i shumë vëllimeve, ndërmjet të cilëve, 25 vëllimet e "Acta Albaniae Veneta". Nder mësues shqiptarë: Filip Ashiku, Gaspër Benusi, Pjetër Marubi, Fejzullah Efendi, Kolë Dema, Dom Ndre Mjeda, mësuesi ynë i paharrueshëm, siç thoshte Valentini; Etërit Mark Harapi e Zef Saraçi; Gjush Sheldija, bashkëpuntori i ngushtë i Valentinit; Musa Efendi Boriçi, Mati Logoreci, Gjon Qerraxhija, Kolë Thaçi, kater Gurakuqë, tre Rrota (vëllezërit e Pater Justin Rrotës), dy Çefa e deri te dijetari i thellë, i persekutuari i paepur e mbrojtësi i të drejtave të njeriut, Atë Pjeter Meshkalla, emrin e të cilit gëzon sot shkolla e rilindur saveriane.



Procesin mësimor e ndihmonin edhe ambientet shkollore, si kabinetet e fizikës e të kimisë e, sidomos, biblioteka shumë e pasur e jezuitëve.

Këtu, si fort rrallë gjetiu, gjindeshin veprat e autorëve tanë të vjetër: Bardhit, Bogdanit, Budit, këtu 'Illyricum Sacrum', dhe 'Gramatika' e parë shqipe e Françeskos prej Leçes (1716), si thoshte Mjeda; e para gramatikë në Ballkan; "Historia bizantine" e Du Fressne e Du Cange, pastaj veprat e Hahnit, Mayer, Joklit, Kamardes, Kristoforidhit etj. etj. dhe skedari i famshëm i Valentinit, dorëshkrime e dokumente me rëndësi, të cilat më vonë do të grabiteshin, do të digjeshin, do të zhdukeshin, e çka do të tepronte, do të çohesh për karton.

Por, nëse puna matet me rezultatin, atëherë vjen natyrshëm pyetja: 'Cila shkollë ka pasur rezultate më të mira, më të frytshme se kjo shkollë?

Këtu mjafton të kujtojmë vetëm disa nxënës, emrat e të cilëve flasin vetë: "Imzot Lazër Mjedën, meshtar e atdhetar i flaktë, themelues i shoqërive letrare e botuese, mecenat e lavrues i letrave shqipe; Imzot Luigj Bumçin, anëtar e pastaj kryetar i Dergatës shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris, senator i Shqipërisë; Imzot Prengë Doçin, luftëtar i

idealeve të binomit "Fe e Atdhe", politikan e diplomat, themelues i shoqërisë "Bashkimi" e autor krijimesh artistike; Faik Konicën, aristoklatin elegant të letrave shqipe, stilistin e madh e, së fundi, djaloshin e jashtëzakonshëm, Luigj Gurakuqin, përfaqësuesin e politikës kombëtare e "pionierin e qytetërimit evropian", pastaj nxënës të tjerë të shumtë, që u bënë drejtues të administratës shqiptare, kur kjo hidhte hapat e para të jetës vërtetë demokratike.

E ajo që do ia rritë më shumë emrin e mirë kësaj shkolle, janë shumë profesorë e nxënës, që pritet të ngjiten në nderimet e elterit si martirë të fesë e të atdheut. Kujtojmë Imzot Bonatin, Atë Faustin, Atë Dajanin, seminaristin Mark Çuni, të pushkatuarit Dom Lazër Shantoja, Pater Anton Harapi, Dom Alfons Tracki, Dom Mark Dushi, Dom Dedë Maçaj, Dom Zef Bici, Dom Pjetër Çuni, Dom Luigj Pici, Dom Mark Gjani e Dom Lazër Jubani, që vdiq i helmatisur nga sigurimi komunist.

E përfundojmë këtë përkujtim të shkurtër me vlerësimin e Faik Konicës: "Me këto e të tjera, Kolegji Saverian mbahet në një shkallë të lartë dhe të gjithë ata që kanë parë shkollat e Francës e të Evropës munden të dëshmojnë se ajo e Shkodrës është e zonja për shumë punë, të vihet në një me to".

KAÇORRI-PERANDORIT FRANZ JOSEF : MOS LEJONI COPËTIMIN E SHQIPËRISË

100 vjetori i Zv/ Kryetarit të Qeverisë së Vlorës, Dom Nikollë Kaçorri (1862-1917)

Këto ditë po shihja me andej në një emision televiziv, zhvillimin e ceremonisë solemne për riatdhesimin e rivarrimin e eshtrave të ushtarakut student, patriotit Shahin Toci, sargu i të cilit u prit në aeroportin e Rinasit me 26 mars 2011, me shumë nderime, ashtu siç e meritonte ky djalë trim që i qëndroj besnik deri në flijim flamurit tonë kombëtare.

I pushtuar nga emocionet e pamjeve nga ceremonia, ku shihje dhjetëra njerëz që valëvitnin ndër duar flamurë kombëtarë, dalloje në qëndrim nderimi, ministra e personalitete të shtetit të veshur me uniforma shumëngjyrëshe në homazh të këtij trimi liridashës, po mendoja se pothuajse para një muaji (me 9 shkurt 2011) zbrita nga avioni i linjës Wien-Rinas po me të njëjtin qëllim, për të riatdhesuar pas 94 vjetësh eshtrat e DOM NIKOLL KACORRIT - ARKITEKTIT TE PAMVARSISE E TE SHTETIT SHQIPTARE që gëzojmë sot, por me një ndryshim të madh, se atë ditë "te zeze për ndjenjën kombëtare", sargun me eshtrat e titanit nuk e priste asnjë personalitet, ministër, gjeneral, zv/minister apo drejtor drejtorie.... bile as edhe një klerik i lartë.

Sytë mu mbushen me lot dhe tërë qenien time ma pushtoj një ndjenjë keqardhje dhe turpi.

Me ditë të tëra isha munduar të lajmëroj për ardhjen e eshtrave të Imzot Kacorrit, personat përgjegjës të shtetit, që nga institucionet më të larta, ministritë, kuvendin, deputetët e Durrësit, hierarkinë e lartë kishtarë të dioqezës së Tiranë –Durrësit, me telefon e po ashtu me postë elektronike.

Asnjë reagim. Situata e krijuar më solli ndër mend që veprimi im nuk i sillte kujt ndonjë përfitim ekonomik (për të cilin do të ishin prezent të gjithë ato persona që përmenda më sipër), por ishte vetëm



një veprim moral e patriotik për të cilin më ishin përgjigjur njerëzit e thjeshtë të ardhur në grupe nga Durrësi e Lura.

Çfarë paradoksi. Një burrë i madh, etalon i patriotizmit, lirisë dhe atdhedashurisë, prift katolik i cili kishte deklaruar me gojën e tij..." ...për mua së pari atdheu mandej kisha...", nuk u vlerësua, ose u la në harresë me dashje, ashtu sikurse u la në harresë për 94 vjet në dhe të huaj. Perse duhej që aktiviteti i tij të shihej vetëm nën petkun e priftit katolik, që të pasojë me një sjellje të tillë? Apo kaq e madhe ishte propaganda komuniste kundër këtij atdhetari sa që njerëzit vazhdonin ta shihnin si "klerik reaksionar"???

Dëshiroj të sjell me poshtë për lexuesit një dokument original të gjetur në arkivin e ministrisë

së jashtme në Vjenë, ku çdo njeri edhe ato me skeptikët mund të shohin e të binden për punën e madhe që Imzot Nikollë Kacorri bëri në dobi të atdheut të robëruar nga hordhitë aziatike osmane.

Dokumenti mban datën 12 nëntor 1912 dhe është një letër e shkruar dhe formuluar nga Imzot Kacorri, e cila i drejtohet Perandorit Franz Josef të parë në Vjenë, për ta vënë në dijeni që; shqiptarët nuk e durojnë më robërinë. Ato duan tashmë pavarësinë, të drejtën e shkollave, kulturës, traditave e gjuhës së tyre. Ato kërkojnë përmes kësaj letrë, mbështetjen e perandorisë më të madhe të kohës për të mos lejuar copëtimin e Shqipërisë nga vendet fqinje në Ballkan.

Madhnisë të Tii

Franz Josef I

Përandorit e Mbretit të Austro – Magjarisë në Vienë

Shum të vështira e të rrezikshme jan këto dit per ne Shqyphtarët e per nanën t'on Shqypninë qì të kater shtetet e Ballkanve po rrâin me e perpië a me e coptue. Na me sâ fuqi ë kena mundohena edhe Përendisë i lutena qì Mbretnia jon të muisi këta anmiq e të na prui prej sish. Por per fat të keq gjasat nuk po na duken fort të mira, e po shohim se shum vende të kater vilajeteve të Shqypnisë, Kosovë, Manastir, Shkodër e Janinë gjinden nden kambë të hueja.

Per këtë shkak po marrim lejen m'u sjelle kah Madhnia Jote si Përandorit të një Përandorisë të madhe, qì asht ma e afermia e jon e ka pjesë në Ballkan me Bosnie – Herzegovinë, e me Ju lutun qì në çeshtjet të Ballkanve të merret para syshë edhe Shqypnia në mënyrë qì kufit e sajë mos të përkiten e mos të shtyhen prej kerkui e qì Shqypnia kështu e pà bërka me e pà vogluëme të ketë një Automië të plotë nden Mbretninë Otomane.

Por në kioftë se per fat të zië qillon, qì kio Mbretnië nuk ka me muit ma mbas luftesë të sotshme me sundue në kurrfar mënyre Shqypninë, na nga thelbi i zembrës i 'ate qì Shqypnia prej kater vilajetesh permendun sipri me tre milion e sâ Shqyphtarë të bahet një Mbretnië në vehte sikurse të tjerat shtete të Ballkanve, në daç perse Shqyphtarët jan një kambë ma i vjetri ner këta, me një gjuhe e me zakone fare të veçanta, e gjaku i tyne nuk mundet me paitue kurrsesi me çdo gjak të kombeve qì jan rreth e rrotull; në daç perse nuk do t'ishte e drejtë humbja as voglimi i një kombi Shqyphtarë, i cilli nuk është

aspak ma i poshtem se kombët e tjera të Ballkanve si per numer, ashtu permendë, si per vjeften morale, me të cillën, sado qì per një kohe shekuish shum të gjatë kje rrahun në çdo krah e në çdo mënyrë prej shum e shum tallazeshë politike qindroi në kombësië të vet e në zakone të veta, por si një shkambë i fort në mjedis detit; e kjarishtë e diftoin edhe theroritë e mëdhaja qì Shqyphtarët hoçën perrain, gjytetërimin, e perparimin e Kombit të vet në këtë kohe të mrame të Tyrqëvet të Rie: në daç edhe perse na duket se një Mbretnië Shqyptare mban peshën jo vetem të Ballkanve, por edhe të gjith shteteve t'Europës, e sidomos në muitm'ubâa, mbas dishiritt'on, njimbretnië e pa anë (neutre), sikurse Belgji e Svizzera.

Prej gjithkë tyne shkaqeve e arsynave na e pështesim të tanë shpresën t'one në ma të madhen mirsine e Madhnisë Tande per të cillën na e gjith kombi Shqyphtarë ka per të Jauditun per nderë per gjithmonë.

Me shpresë të madhe qì të lutunatt'ona kam me e bërka zembrën e Madhnueshme të Madhnisë Tande kemi nderjen ma të madhen me vuë këtu duërtt'ona e m'u permendun.

Shqypnië, 12 Nanduer 1912

Të Detyrushmit Sherbëtorë te Madhnisë 'ate

Firmat

Nikoll Kaçorri Prift, Mustafa Asim Kruja, Reaçep Mitrovica, Fuad Toptani, Abdi Toptani, Murad Toptani, Salih Gjuka-Ipek, Bedri Pejani.

Letra është e shkruar në tri faqe. Ajo është e firmosur nga drejtuesit kryesorë të komitetit të përgjithshëm të kryengritës së Shqipërisë së mesme: Nikoll Kacorri, Fuad Toptani, Murad Toptani, Abdi Toptani, Mustafa Kruja, Rexhep Mitrovica, Salih Gjuka, Bedri Pejani, Mustafa Kruja.

Letra i është dorëzuar Konsullit Austriak në Durrës, Rudnay, i cili së bashku me letrën, dërgon në ministrinë e jashtme në Vjenë, personalisht për ministrin e jashtëm Leopold Grafen Berchtold me shënimin "shumë konfidenciale", një përshkrim për gjendjen e vështirë dhe shpërthyesë, të krijuar në zonën e Shqipërisë së mesme.

Në shënimin e tij po të këtij viti, Rudnay shkruan: "mbasi unë pashë qëndrimin e palëkundur të popullit, i cili pretendon të bëhet një kongres për shkëputjen e vendit nga perandoria dhe kërkon përjashtimin e të deleguarve të huaj nga Mutesarifit në kongres, po ashtu dhe pasi dëgjova pretendimet

e ortodoksëve të cilët kërkojnë një pushtues të huaj që të mos sundohen më nga shumica myslimane, vendosa me iniciativën time të marr përsipër, me kërkesat më të pranueshme për ne, këtë letër që sollën të deleguarit.

Në një bisedë që pata me famullitarin e Durrësit Don Nikollë Kaçorin dhe Murad Bey Toptanin i theksova atyre që Monarkia mbron interesat e Shqipërisë pa e pushtuar atë, e dëshiron që shqiptarët në këto kohë të vështira të bashkohen me njeri tjetrin. Gjatë bisedës i tregova atyre edhe motivet kryesore të mbështetjes tonë.

Gjatë ditës kam marrë nga Don Kacorri, në mirëbesim, letrën me kërkesa për Madhërinë e tij, ku sipas këshillës sime u hoqën disa pika të pakuptimta. Murat Topatani, të cilit i detyrohesha t' i ktheja një vizitë më konfirmoi më vonë që delegatët tremben se kongresi do të dështojë, e kanë vendosur menjëherë ti dërgojnë madhërisë së tij këtë kërkesë. Sapo i hodha një sy letrës, pashë që të gjithë delegatët kishin pranuar, ato çfarë kishim diskutuar me Don Kaçorin.

Aty kërkohet autonomi e vendit, por nën sundimin turk, e po qe se kjo është e pa mundur, atëherë të kërkohet Pavarësi dhe Neutralitet. Unë jam munduar që letra të stilizohej në mënyrë që të kishte hapësira për ndryshimet e mundshme (për të përjashtuar ndikimin e fuqive të tjera), pa cenuar angazhimin tonë. Pas dorëzimit të kësaj letrë, kam bërë marrëveshje, që unë nuk do të përdor ndikimin tim në Kongres dhe nuk do të marr përsipër asnjë ndërhyrje aty.

Gjithashtu kam konfirmuar që për sa kohë të zgjasë Kongresi dhe ndikimi turk në vend, do pranoj të bisedoj apo veproj vetëm në mënyrë konfidenciale. Nga delegatët të cilët kanë nënshkruar këtë dokument, vetëm Mithat Frashëri ka nënshkruar menjëherë, por edhe të tjerët nuk kanë vonuar ta nënshkruajnë.


Së fundi dëshiroj të ju bëj të ditur shkëlqesisë tuaj, që zotërinjtë presin të marrin nga ju një përgjigje të pranueshme. Si gjithmonë me lejen tuaj, arrita të ndikoj sadopak pozitivisht në Kongres. Edhe një herë dëshiroj të ju bëj të ditur se kam vendosur, nëse Kongresi i Shqiptarëve do të pengohet, të kërkoj nga Elita e shqiptarëve një dokument, i cili nuk do na sjellë detyrime anës tonë, që do të mund ta përdorim në situata të vështira që mund të krijohen", përfundon letra e konsullit Austriak në Durrës.

Kuptohet qartë se interesat tona kombëtare, ato të Dom Nikollës përputheshin me ato të Austro-

Hungarisë, e cila kërkonte që influenca e saj të shtrihej në tërë Ballkanin. Kjo ishte arsyeja që konsulli Rudnay mbante kontakte të ngushta me atdhetarët shqiptarë, të cilët morën përsipër misionin që të njoftojnë fuqitë e mëdha se populli shqiptar do ti merrte armët në dorë për ti dale zot territoreve të veta. Dera e Dom Nikollë Kaçorrit ishte kurdoherë e hapur për atdhetarët. Aty bëheshin mbledhjet e komitetit e ndërmerreshin vendime të rëndësishme për lëvizjen popullore.

Dëshiroj të mbyllë shkrimin tim me fjalët e Mustafa Krujës: "Shqipëria për Dom Nikollë Kaçorin, Atdheu, liria e saj ishte ideali i tij.... Dom Nikollë Kaçorri ishte shqiptar me plot gojën...e deri më sot, s'më ka rënë të këndoj gjikund ndonjë rresht që ta përmendi sado për keq emrin e tij, megjithëse ka qenë përkrah Ismail Qemalit në Vlorë, edhe nënkryetar i denjë i së parës qeveri shqiptare, i zgjedhur prej atij kuvendi kombëtar, që shpalli pavarësinë e atdheut, dhe që mundi të krahasohet për rëndësinë e tij historike, vetëm me Kuvendin e Lezhës.... gati pesë shekuj më pare".

Dossier nga Pjeter Llogoreci



Ndue Dedaj
Rrëshen

FAMULLIA E GOMSIQES, SELIA E "KANUNIT" TË GJEÇOVIT

Gjeçovi ishte modeli i dijetarit shqiptar që rroi e veproi në provincë. Nëse shumë nga dijetarët e kohës merreshin me punë shkencore në Shkodër e Tiranë, pranë arkivave, bibliotekave dhe bërthamave shkencore, At Shtjefni e ndërtoi aty ku shkoi qendrën e tij kërkimore - shkencore, duke filluar nga skedat, gjetjet arkeologjike, eksponatet etnografike etj., ku ishin dhe librat në shqip e gjuhë të huaj. Famullia mes malesh ishte dhe objekt kulti i formimit shpirtëror të banorëve, edhe vatër e dijes shkencore.

Në të vërtetë asgjë e re nuk kishte ndodhur, po të kemi parasysh historinë e murgjëve në botën Perëndimore, të cilët luteshin, studionin dhe punonin tokën. Por lajmi është se kjo nuk bëhet në abacitë e manastiret e Francës, Anglisë, Spanjës, Italisë, Austrisë, Polonisë, Portugalisë etj., me traditë në këtë lëmë, por në Shqipërinë e varfër të Veriut, ku doket, këngët, përrallat e sendet e vjetra të visarit kulturor kombëtar po bjerreshin dita - ditës e po të mos mblidheshin e dokumentoheshin me hyrjen e shekullit XX, brezat që do të vinin nuk do t'i kishin më ato. Në kontekstin shqiptar, famullia si metaforë kulturologjike është shumë më tepër se gjurmimi dhe arkivimi i së vjetrës. Autori shqiptar, shkrimtari, ka dalë nga një kishë, nga famullia e përndritur e Buzukut. E para që Fjala... e Mesharit, "tue klenë ma e para vepër" e fort e fështirë për të vepruom mbë gluhët tanë."

Që nga ajo ditë kur ky libër parak doli për së pari në vitrinë, autori shqiptar ka nënshkruar sipas stilit të patjetërsueshëm: "U Don Gjoni, biri i Bdek Buzukut..." A mund të kuptohen pa famullinë shkrimtarët e tjerë të vjetër: Pjetër Bogdani, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Gjon Nikollë Kazazi, Pali i Hasit? Apo ipeshkvi i Arbënisë Mark Skura, i Durrësit Rafaele D'Ambrozio, prelati i Pavarësisë Dom Nikollë Kaçorri etj? Nga një famulli malesh matjane kemi dhe dokumentin e parë të shqipes, "Formulën e Pagëzimit" të Pal Engjëllit. Ka një vazhde shkrimore që nga lashtësia. Shën Hieronimi (340-420), autori romak me origjinë ilire është dhe prijëtar i kësaj race të ndritur diturakësh. Janë këta punëtorë të urtë të letrave që i konfiguruan si qendra studimore famullitë nëpër malshejte, kryekrejt Kuvendet Benediktine, ku punonin tokat e vreshtat, shkruanin, transkriptonin e arkivonin. Ndërkohë që rapsodët popullorë nxitonin të shqiptonin epet, këngët e kreshnikëve, të motmotit, të historisë, këngët e lindjes dhe të vdekjes, të cilat do t'i regjistronin në letër famullitarët kulturologë Bernardin Palaj, Donat Kurti, Aleksandër Sirdani etj. Famullia (mungada, abacia, ipeshkvnia) nuk do të rreshtte së krijuari dhe nënshkruari shqip thelbet e identitetit shqiptar.

Gjeçovi e ridimensionoi kuptimin e famullisë si qendër kërkimi e studimi. Ai kishte shkopin prej druri bushi si dëshmitar të adresave nga i shkeli këmba, nga

Malësia e Madhe në Labëri, Mirditë, Pejë, Gjakovë, Elbasan, Berat etj., i cili niste me fjalët e skalitura "Rrnoftë Shqypnia". Rreth 30 vite më atë shkop në dorë si një "plak" i dijes, arkeologu dhe etnologu i parë shqiptar. Shkopi emblematic i Gjeçovit, të cilit poeti Xhevahir Spahiu i ka kushtuar një poezi, ruhet në muzeun e Shkodrës, duke qenë udhërrëfyesi i çuditshëm i shtegtimeve të dijetarit heroik.

Harta misionare e Gjeçovit dhe e veprës së tij të jetës, "Kanuni i Lekë Dukagjinit", rrok mbarë trojet dukagjinase e më gjerë trevat shqiptare: Kryezi, Janjevë, Troshan, Lezhë, Shkodër, Bogë, Pejë, Gomsiqe, Orosh, Kashnjet, Rubik, Laç (Sebaste), Vlorë, Zllakuqan, Zym etj. Në të gjitha këto, në rend të parë është famullia e



Gomsiqes në Mirditë, urëlidhëse me Shkodrën, Pukën e Dukagjinin. Është Faik Konica, aristokrati i metropolit shqiptar-amerikan, që e skicon më pak radhë famullinë e Gjeçovit, i mahnitur prej asaj, si studio kërkimore dhe muze i eksponateve arkeologjike, etnografike etj., duke e quajtur Gjeçovin "një nga njerëzit më të lartë të Shqipërisë", që asokohe "merrej me institutet e vjetra të Shqipërisë, nga të cilat një që arrin deri në ditët t'ona është Kanuni i Lekë Dukagjinit. Askush nuk mund t'i afrohej At Gjeçovit në diturin e këtij Kanuni... Në kat të sipërm të famullisë, përmi një tryezë të madhe, ishin shtruar një tok vjetërirash greko-romane, të zbuluara e të mbledhura një nga një, me një fatbardhësi të rrallë dhe me një shië të mbaruar, nga dora e vetë At Gjeçovit". Kjo ishte famullia shqiptare e gjysmës së parë të shekullit XX jo vetëm në Gomsiqe, por kudo. Shoqëria "Bashkimi" e Shkodrës e udhëhequr nga Abati Prend Doçi ishte një akademi kërkimore me filialet gjithkund nëpër famullitë e veta.

Pas elitës kishtarë të mesjetës, u përvijua një vazhde e re prelatësh të penës e dijes në kohën e Rilindjes, si At Leonardo De Martino në Troshan, Dom Mikel Tarabolluzi në Stubëll të Epërme të Karadakut, Pjetër Zarishi në Orosh, Dom Ndoc Nikaj në Shkrel, Dom Ndre Mjeda në Kukël, At Gjon Karma në Pukë, Imzot Luigj Bumçi në Kallmet, At Bernardin Palaj në Dukagjin, Dom Nikollë Kimza në Kalivare, Dom Dodë Koleci në Ndërfanë, At Pal Dodaj në Rubik, At Pashk Bardhi në Vig, Dom Prend Suli në Kashnjet, Dom Nikollë Gazulli në Shkrel, Dom Nikollë Mazreku në Kryezi, Dom Zef Oroshi në Ungrej etj., famullitë e të cilëve ishin dhe çerdhe krijuese e studimore. Misioni kombëtar i famullisë shtrihet deri në Vlorë ku Dom Mark Vasa stilizonte flamurin kombëtar që do të ngrihej në qytetin historik më 1912. Fishta dhe Gjeçovi ishin dy nga majat e elitës françeskane që krijuan kulmet e korpusit kulturologjik, me "Kanunin e Lekës" dhe "Lahutën e Malcis", duke mundësuar: i pari kalimin nga rapsodi anonim te autori i mirëfillt letrar, që nuk shkëputet mënjëherë nga filli i traditës krijuese dhe i dyti - duke marrë mbi vete "autorësinë" e Kanunit, që deri atëherë e kishte populli. Prandaj janë dhe dy fretërit më të popullarizuar në gjysmën e parë të shekullit XX, me njohje dhe jashtë vendit.

Gjeçovi i bëri kullat e maleve pjesë të studios së vet. Dy nga bardët e shquar nga të cilët mblodhi lëndë të shumtë e të vyer kanunore ishin: Çup Kolë Skana i Oroshit dhe Palucë Prengë Gjoni i Kashnjetit, ashtu si dhe ndonjë kapidan nga Gjomarkajt. Këta bashkë me Ndue Prengë Nikollë Lleshin e Simonit, Pleqtë e Fanit e të tjerë ishin pleqnarë kanuni dhe Plak Kanuni ishte titull fisnikërie, i ndryshëm nga titujt e parisë së krahinës, flamurit apo fshatit, që ishin të trashëguar. Titullin plak kanuni e fitojë falë aftësive individuale në zgjidhjen e konflikteve dhe nuk e trashëgoje. Plaku i Kanunit ishte mishërimi i drejtësisë në sytë e publikut. Pleqtë kanunarë të dëgjuar merreshin dhe në krahinat fqinje për të pleqëruar. Askush më mirë se Gjeçovi nuk e ka njohur këtë racë siperane, prej së cilës ai "voli" Kanunin ditë pas dite e javë pas javë. Famullia e tij e Gomsiqes, ku qëndroi mbi dhjetë vite, dalëngadalë vjen e merr atributet e një instituti kulturologjik. Kishte ardhur një kohë kur famullitarët e maleve ishin njëherësh bashkëpunëtorë të organeve të shtypit kulturor - fetar, si Hylli i Dritës, LEKA, Kumbonma e së Dielles etj.

Në këtë kundroje, shqiptari i sotëm një ndalesë duhet ta bëjë me doemos në Kuvendin e Arbnit (1703) në Mërçi (Lezhë), pasi ai tempull bekoi një kuvend historik shqiptar të përmasave kombëtare, për të ngritur aty një obelisk. Ashtu siç do t'i duhej ta zbulonte Prend Doçin, në të dy "abacitë" e tij, atë të Oroshit dhe shoqërinë "Bashkimi" (Shkodër), që i dha këtij kombi alfabetin e vet me shkronja latine, me të cilin shkruajnë dhe nënshkruajnë sot e gjithë ditën shqiptarët kudo janë. Ravës për tek autori shqiptar kemi për ta takuar patjetër Dom Ndoc Nikajn (në Dajç të Bregut të Bunës etj.), duke u marrë me Historinë e Shqipërisë (të parën histori të saj), Shkodrën e Rrethueme, Bukurushën (të parat romane shqipe), apo gjuhëtarin e përvutë me emrin pak të

dëgjuar, Dom Dodë Koleci, që i ngulur në famullinë e Ndërfanës (Mirditë) hartoi Fjaluer i Ri i Shqipes (1908). Famullia kulturologjike ishte dhe në "Andrrën e jetës" të Ndre Mjedës, lirikat e qytetit të vet të Vinçens Prenushit, melodramat e Ndre Zadejës, muzikimet e At Martin Gjokës e Dom Mikel Koliqit, i pari kardinal shqiptar. Në një nga famullitë më të vjetra shqiptare, atë të Shën Demetrit të Kalivares (1154) të Dheut të Spaçit historiani Dom Nikollë Kimza shkroi artikuj të vlefshëm sidomos për historinë e Mirditës, por dhe të Tiranës, apo në famullitë e shumta ku shërbeu Dom Prend Suli mblidhte "kokrrat e vjetra mirditore", folklor dhe doke të trevës, si dhe plot famullitarë të tjerë shkrimtarë, gjuhëtarë, etnologë, piktorë, muzeologë, arkeologë etj. Një meritim të madh kulturor kanë famullitarët e vonë, dijetarë të shquar, Dom Simon Filipaj në rrethinat e Ulqinit, përkthyesi i Biblës në shqip dhe At Vinçens Malaj që u shkri si qiriri në bibliotekën e tij albanologjike në famullinë e Tuzit për të na sjellë përmes dëshmime arkivore të Vatikanit Kuvendin e Arbnit. Në një famulli të shuar mund të jetë dhe "monumenti më i rëndësishëm i Shqipërisë Veriore", na thotë gjeografi i njohur Armao, për manastirin Benediktin të Shirqit në bregun e Bunës Shkodër, i ndërtuar nga ilirët në shekullin VI. Në famulli arbnore Shkodre, Mirdite, Stublle, Dhërmu, Kurbin, Vele, Pllane, Blinishti, Oroshi, Gjakove, Prizreni, Shkupi, Zllakuqani kemi shkollat e para shqipe; misonarët shëtitës të pajtimit të gjaqeve Jungu e Passi në gjysmën e dytë të shekullit XIX, albanologët e shquar Zef Valentini, Fulvio Cordignano etj., parlamentarët e parë At Gjergj Fishta, At Ambroz Marlaskaj, Dom Ndre Mjeda etj.

Na duhet ta pohojmë e dëshmojmë me studime e publikime rolin kulturor të famullisë shqiptare veçanërisht në kapërcyell të shekullit XX e gjysmën e parë të tij pa u tutur se po shkasim në ndonjëfarë "religjionizmi" kulturor, ngaqë vijmë nga një botë ideologjike e paqëruar nga ateizmi komunist, nga një laicitet me deformime dhe shkojmë drejt një bote "vigilente" ndaj qasjes dhe spektrit të besimeve etj.

Në stilin e meshtarëve të vjetër, veçanërisht françeskanëve, janë marrë një jetë me letërsi, gjurmime, shkrime e përkthime edhe intelektualë të tjerë larg metropolit, si Lasgush Poradeci në Pogradec, Jakov Xoxa në Apolloni, Ndoc Gjetja në Lezhë, Dom Frano Illiaj në Kurbin, Dom Simon Filipaj në Shëngjergj & Kilezë të Ulqinit, Dilaver Kurti në Mat, Fatos Mero Rrapaj në Myzeqe, Xhemal Meçi në Pukë, Shtjefën Ivezaj në Tuz, Prend Buzhala në Klinë, Gjon Gjergji në Krushë të Vogël, Agim Faja në Shijak, Gjergj Vlasi në Durrës etj. Së fundi, në Gomsiqe, fshat mirditor i skajit perëndimor, do të ishte me vend të kishte një muze të Kanunit, ku të përjetësohej vepra e pashoqe kërkimore-shkencore e At Gjeçovit. Mjafton të shohim se si e ka ngjallë në Kukël të Zadrimës tempullin e Ndre Mjedës famullitari dhe historiani bashkëkohës Dom Nikë Ukgjini. Madje është bërë vonë për një muze të Gjeçovit në Gomsiqe, për më tepër në kohën e turizmit kulturor.

“WORKSHOPE” NJË NXITJE E TË RINJVE NGA EVROPA

Shkodër, 16-19 gusht 2017.


“Got Peace” është një projekt në formën e një kampi veror, i nisur rreth 20 vite më parë, nga një grup priftërinjsh gjermanë të vendosur në famullitë kryesore të zonës së Dortmundit. Shkëndija e kësaj nise ka qenë lufta e fundit në Ballkan në vitet 1992-1995. Hera e parë ka qenë zhvilluar vitin 1996 në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë, ku si qëllim kishte nxitjen e të rinjve nga e gjithë Europa të cilët duke u grumbulluar dhe jetuar për 10 ditë s'bashku do promovonin paqen dhe rindërtimin e shoqërive të pasluftës. Në Bosnjë-Hercegovinë u zhvillua për shumë vite më radhë deri në vitin 2014, kur u përkujtua 100-vjetorin e fillimit të Luftës së Parë Botërore. Dhe më pas në vitin 2015 u organizua në Kamen, Gjermani.

Këtë vit nga 16 – 19 gusht 2017, u organizua në Shkodër - Shqipëri për dy motive: ngjarja e rëndësishme për kishën dhe Shqipërinë ishte shenjtërimi i Nënë Terezës (më 4 shtator 2016) dhe Lumnimi i 38 martirëve (më 5 nëntor 2016). Më këtë rast u mbajtën disa aktivitete si: vullnetarizmi, piktura, kërcimi, muzika, sportet, dialogu ndërfaqësor, ide inovative etj., në Fshatin e Paqes në Tarabosh dhe festa kulmore ishte ajo në oborrin e sistemuar të Katedrales së Shkodrës më 19 gusht në orët e pasdites.

Esenca e këtij evenimenti do vazhdoj të jetë paqja dhe dashuria e treguar nga bashkëjetesa dhe bashkëpunimi i të rinjve nga gjithë Evropa. Të ndërgjegjësuar, pavarësisht fushave të ndryshme teknike, politike, kulturore e fetare, sepse në thelb njerëzimi është një i vetëm. Tek të gjithë duhet të mbizotërojnë qëllimet pozitive për shoqërinë dhe të ndërtuarit e urave me njëri-tjetrin dhe jo krijimi i mureve ndarëse.

Marrë nga Fb. Katedralja e Shën Shtjefnit, Shkodër.





Akademia e Shkencave
dhe Arteve e Kosovës

NDRE MJEDA
150 VJETORI I LINDJES


Prishtinë - 2016



Don Anton Uka

Fuqia e besimit

Reflektim psiko-shpirtëror
mbi Psalmet 1-19



Don Anton Uka

FUQIA E BESIMIT

Botimet Fishta - Drita
Prishtinë 2017

Justin Godart

SHQIPËRIA NË 1921

Klubi i Poezisë
Tiranë 2015

KUMBONA E SË DIEËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë

KUMBONA E SË DIEËS

Viti XXXI, nr. 7/8 (497-498) Korrik - Gusht 2017